

1 E hënë, 30 shtator 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
13 procesverbal vërej që të katër të akuzuarit janë të pranishëm
14 në sallën e gjyqit sot.

15 Sot do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes
16 1DW-004.

17 Përpara sesa të fillojmë, ka disa çështje paraprake të
18 cilat Trupi Gjykses dëshiron t'i trajtojë.

19 Së pari, më 17 shtator 2025, Trupi Gjykses shënoi një
20 video me numër reference dokumentin 128791-02 dhe transkriptin
21 e videos për identifikim si P04492. Video është një dokumentar
22 i BBC-së që quhet "Lufta morale - NATO në luftë". ZPS-ja
23 dorëzoi këtë video dhe transkriptin e vet gjatë marrjes në
24 pyetje të dëshmitarit të Mbrojtjes së Thaçit 1DW-003 për
25 qëllim të diskreditimit dhe për vërtetësinë e përmbajtjeve të

1 veta. Mbrojtja e Thaçit kundërshtoi pranimin, duke argumentuar
2 që dëshmitari nuk ka njohuri për videon dhe nuk shtoi asgjë
3 tjetër lidhur me këtë.

4 Në kundërshtim me parashtrimin e ZPS-së, Trupi Gjykses
5 nuk është bindur që video lidhet me kredibilitetin e
6 Dëshmitarit 1DW-003. Megjithatë, Trupi Gjykses është bindur që
7 videoja është relevante përderisa përmbajtja e saj
8 mjaftueshmërisht lidhet me çështjet që kanë të bëjnë me këtë
9 çështje gjyqësore, përfshirë këtu dhe pozicionin e z. Thaçi
10 dhe konferencën e Rambujesë.

11 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses është bindur që
12 autenticiteti *prima facie* i videos ka relevancë për shkak të
13 origjinës, përfshirë këtu emrin e raportuesit ose të gazetarit
14 ose agjencinë transmetuese dhe datën kur është transmetuar
15 materiali në fjalë.

16 Lidhur me vlerën provuese, Trupi Gjykses është bindur që
17 ekziston kontekstualizimi mjaftueshëm në lidhje me materialin
18 në video. Trupi Gjykses më tej bindet që vlera provuese *prima*
19 *facie* nuk zhbëhet nga asnjë paragjykim ose asnjë cenim ndaj
20 palëve të tjera të tjerat kanë pasur mundësinë që ta marrin në
21 pyetje këtë dëshmitar.

22 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se dokumenti me
23 numër provizor prove MFI P04492 përmbush kriteret sipas
24 rregullës 138 dhe pranohet pjesa e kësaj videoje nga minuta
25 44:02 deri ë minutën 45:30 dhe faqet 9 deri në 10 të

1 transkriptit. Duke e marrë parasysh që pjesët e tjera të së
2 njëjtës video janë të pranuar në prova gjyqësore, tani do të
3 pranohet vetëm ajo pjesë të cilën unë e citova më tepër dhe
4 kjo do t'i bashkëlidhet provës ekzistuese P04487. Dhe Trupi
5 Gjykses urdhëron Zyrën Administrative që ta lirojnë numrin
6 provizor të këtij fragmenti më përpara.

7 Ky është fundi i urdhrit të parë.

8 Tani do të vazhdojmë me urdhrin e dytë që ka të bëjë me
9 dokumentin V00036 që është një raport që mban datën 23 maj
10 2022 që është përgatitur nga ekspertët e iMMO-S Karin Duhne-
11 Prinsen dhe Sonja Swen-van Langen në Çështje 05, që tani e
12 tutje unë do t'i referohem si rasti apo raporti iMMO në
13 çështjen 05.

14 Më 18 shtator 2025, sikurse u udhëzua nga Trupi Gjykses
15 për pranimin e akteve të ekspertëve, aktekspertizave të
16 ekspertëve të parashtruara nga Mbrojtësi i Viktimave që kanë
17 numrin e parashtrimeve F03451 në paragrafët 50 deri 60,
18 Mbrojtja e Viktimave ka nxjerrë për palët dhe pjesëmarrësit
19 një version të redaktuar të pjesës së pranuar të raportit të
20 iMMO-s për Çështjen 05. Pjesët e redaktuara të raportit të
21 iMMO-s për Çështjen 05 kanë të bëjnë me pjesë të raportit që
22 lidhen me dëmtimet e bëra mbi individin, prova mbi të cilat
23 është mbështetur Mbrojtësi i Viktimave në këtë çështje.

24 Duke marrë parasysh që Trupi Gjykses ka vlerësuar vetëm
25 pjesën e raportit të iMMO-s për Çështjen 05 që kishte lidhje

1 me çështjen e dëmit mendor që është shkaktuar për viktimat
2 përkatëse dhe ka përjashtuar vlerësimin e pjesës për të cilën
3 flet Mbrojtësi i Viktimave, Trupi Gjykues e udhëzon NJMGJ-në
4 që të zëvendësojë versionin e paredaktuar të F00036 me
5 versionin e redaktuar kohët e fundit duke nxjerrë, që është
6 dokument i cili është nxjerrë nga Mbrojtësi i Viktimave dhe që
7 do të bëhet versioni që do zëvendësojë tanimë V0036.

8 Ky është urdhri i dytë me gojë.

9 Dje, ZPS-ja dërgoi me anë të një poste elektronike -- të
10 postës elektronike një kërkesë për Trupin Gjykues drejtuar
11 Trupit Gjykues, pjesëve dhe pjesëmarrësve duke kërkuar që të
12 shtyhet marrja në pyetje e dëshmitarit më 1 tetor 2025.

13 A dëshiron ndonjëri prej palëve që t'i përgjigjet kësaj
14 kërkesë?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne kundërshtojmë parashtimin e
16 Prokurorisë që jemi me vonesë, sepse ju e dini cilat ishin
17 rrethanat që pse filluam sot me këtë dëshmitar.

18 Dhe, së dyti, ne nuk kemi kundërshtime që Prokurori të
19 vazhdojë nesër me kushtin që ne duhet të përfundojmë deri në
20 fund të javës që të mos detyrohet dëshmitari që të vijë
21 përsëri javën tjetër. Domethënë, nuk kemi kundërshtime me
22 fjalë të tjera.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 [Përkthim] Trupi Gjykues rikujton që pajtim me paragrafët
25 94 dhe 96 të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit, duke marrë

1 parasysh disponueshmërinë e dëshmitarit dhe logjistikën për
2 udhëtime, pala thirrëse duhet të përpiqet që duhet të
3 përfundojë seancat përgatitore sa më shpejt që të jetë e
4 mundur dhe, në çdo rast, të paktën 24 orë përpara sesa të
5 fillojë dëshmia e dëshmitarit.

6 Po ashtu, pala thirrëse duhet që t'ju japë palëve
7 jothirrëse dhe pjesëmarrësve dhe Trupit Gjykses të gjithë
8 informacionin që ka të bëjë me detyrimet për nxjerrje të
9 materialit të palës thirrëse të paktën 24 orë përpara
10 dëshmisë.

11 Në çështjen e Dëshmitarit 1DW-004, shënimet përgatitore
12 që përmbajnë këtë informacione janë nxjerrë pak më vonë sesa
13 24 orë përpara dëshmisë së dëshmitarit. Kështu që për këtë
14 arsye dhe duke marrë parasysh kërkesën për të filluar
15 Prokuroria marrjen në pyetjen më datën 1 tetor, Trupi Gjykses
16 vlerëson që nuk ka pasur ndonjë vonesë të madhe në nxjerrjen e
17 materialeve, megjithatë pranon kërkesën q Prokurorisë që të
18 fillojë marrjen në pyetje të Dëshmitarit 1DW-004 nesër, të
19 mërkurën më 1 tetor.

20 Po ashtu, së fundi, Trupi Gjykses dëshiron që t'ju
21 kujtojë palëve dhe pjesëmarrësve në pajtim me paragrafin 81 të
22 Urdhrit për Zhvillimin e Procesit, në qoftë se pala paraqitëse
23 ose pala që ka thirrur dëshmitarët kanë për detyrim dhe për
24 përgjegjësi që të sigurojë që në fund të dëshmisë së
25 dëshmitarit do ketë një dëshmitar tjetër që është në pritje në

1 mënyrë të tillë që të mos humbim kohë. Pra, duhet që pala
2 thirrëse të sigurojë që të ketë një dëshmitar tjetër në pritje
3 në mënyrë të tillë që të mos humbasim orë të vjera të
4 Gjykatës.

5 Trupi Gjykues që prej fillimit të muajit vëren që janë
6 shpenzuar shumë kokë seancash pa u përdorur në mënyrë
7 efektive. Duhet të merren parasysh që seancat të jenë sa më
8 efektive të jetë e mundur, kështu që Trupi Gjykues i kërkon
9 Mbrojtjes që të bëjë përpjekjet e veta më të mira në mënyrë të
10 tillë që dëshmitarit të presin dhe të ketë një organizim më të
11 mirë për bllokun tjetër të dëshmitarëve.

12 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
15 Dëshmitar.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretari i
18 seancës do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne që do të
19 duhet ta lexoni në pajtim me rregullën 152(2). Ju lutem
20 hidheni një sy dhe më pas lexojeni me zë.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
22 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
23 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
24 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
25 cilën kam dijeni.

1 DËSHMITARI: JAMES COVEY

2 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni
4 tani.

5 Dëshmitar, sot do fillojmë me dëshminë tuaj që pritet që
6 të zgjasë afërsisht dy deri në tre ditë, maksimumi tre ditë.
7 Sikurse mund ta dini, Mbrojtja e Thaçit do t'ju bëjë së pari
8 pyetjet. Mbasi të mbarojë pyetjet Mbrojtja e Thaçit, ekipet e
9 Mbrojtjes, ekipet e tjera të Mbrojtjes, Prokuroria, si dhe
10 anëtarë të Trupit Gjykses kanë të drejtë që t'ju bëjnë pyetje.

11 Mbrojtja e Thaçit ka vlerësuar se i duhen katër orë për
12 t'ju marrë në pyetje. Ndërkohë që tre ekipet e tjera të
13 Mbrojtjes kanë vlerësuar që i nevojiten gjysmë ore. Prokuroria
14 ka vlerësuar që do i nevojiten pesë orë për marrjen e saj në
15 pyetje. Si në raste të tjera, ne shpresojmë që palët do ta
16 përdorin kohën me sa më shumë efikasitet që të jetë e mundur.
17 Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje plotësuese nga palët si
18 dhe pyetje plotësuese nga Mbrojtja dhe nga Prokuroria në qoftë
19 se do plotësohen kushtet përkatëse.

20 Dëshmitar, ju lutem përpiquni që t'i jepni pyetjeve
21 përgjigje të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni
22 një pyetje, lirisht mund t'i kërkonit palëve që ta përsërisin
23 dhe një herë pyetjen ose t'jua bëjnë atë ndryshe. Po ashtu, ju
24 lutem na thoni se cila është baza e njohuri ve dhe fakteve dhe
25 rrethanave për të cilat do të pyeteni.

1 Në rast se Mbrojtja ju kërkon që të vërtetoni disa
2 korrigjime të cilat lidhen me deklaratën tuaj, ju kujtojmë që
3 duhet të konfirmoni për procesverbal që deklaratat me shkrim
4 si dhe korrigjimet përkatëse të marra së bashku pasqyrojnë me
5 saktësi deklaratën tuaj.

6 Ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej
7 pesë sekondash përpara sesa të jepni përgjigje pyetjes edhe
8 flisni ngadalë për t'ju kapur përkthyesit. Gjatë ditëve në
9 vijim, ndërkohë që po jepni dëshmi në këtë Gjykatë, nuk
10 lejohet që të diskutoni me askënd lidhur me përmbajtjen e
11 dëshmisë tuaj jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se dikush vjen
12 dhe ju bën pyetje nga jashtë Gjykate lidhur me dëshminë tuaj,
13 duhet të na e bëni menjëherë me dije këtë gjë.

14 Ju lutem mos flisni më në qoftë se ju kërkoj të
15 ndërprisni së foluri dhe në qoftë se më shikoni që e ngre
16 dorën. Këto duan të thonë që unë do të duhet që t'ju jap disa
17 udhëzime.

18 Nëse e ndjeni të nevojshme për të bërë një pushim, ju
19 lutem na e bëni me dije këtë gjë dhe ne do të bëjmë
20 organizimet përkatëse.

21 Do fillojmë së pari me pyetjet e Mbrojtjes së z. Thaçi.
22 Pas këtyre pyetjeve do të vazhdojmë me pyetjet e ekipeve të
23 tjera të Mbrojtja dhe me ZPS-në.

24 Z. Misetic, fjala për ju.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Z. Kryegjykatës.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 9

1 Pyetje nga z. Misetic:

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

4 PË. Mirëmëngjes.

5 PY. Ne jemi takuar më herët, megjithatë për procesverbal, unë

6 quhem Luka Misetic dhe unë jam avokati mbrojtës i Hashim

7 Thaçit. A mund të na thoni si quheni për procesverbal?

8 PË. Unë quhem James Peter Covey, por profesional edhe nga

9 miqtë e mi unë njihem si Jock Covey.

10 PY. Faleminderit. Ju lutem na thoni datëlindjen.

11 PË. Unë kam lindur më 7 mars 19944.

12 PY. Çfarë shtetësie keni?

13 PË. Jam amerikan nga SHBA.

14 PY. Është e nevojshme që të bëjmë një pauzë midis pyetjeve

15 dhe përgjigjeve se kemi tendencë që të flasim më shpejtë sesa

16 duhet. Do ju kërkoja edhe juve ta bënit këtë gjë.

17 PË. Faleminderit.

18 PY. A i keni dhënë një deklaratë Mbrojtjes së Thaçit të cilën

19 e keni nënshkruar më 12 gusht 2025?

20 PË. Po.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të

22 paraqesë në ekran dokumentin DHT111849 deri në DHT11864.

23 PY. Z. Covey, a e njihni faqen e parë të kësaj deklarate?

24 PË. Po.

25 PY. A është kjo një kopje e deklaratës që i keni dhënë

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 10

1 Mbrojtjes së Thaçi?

2 PË. Po.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen e parafundit
4 të këtij dokumenti, z. Sekretar, që është DHT11863, drejt
5 fundit të faqes.

6 PY. Z. Covey, a është nënshkrimi juaj ky nënshkrim që keni në
7 ekran?

8 PË. Po.

9 PY. A e keni nënshkruar ju këtë dokument, z. Covey?

10 PË. Po.

11 PY. a e keni pasur mundësinë që ta rishikoni dhe ta rilexoni
12 dokumentin përpara sesa ta nënshkruanit?

13 PË. Po.

14 PY. A keni pasur një tjetër mundësi për ta rishikuar këtë
15 dokument duke filluar nga java më përpara dhe duke vazhduar më
16 tej këtë javë?

17 PË. Po.

18 PY. A patët mundësi që të takoheshit me mua dhe me kolegët e
19 mi kësaj jave?

20 PË. Po.

21 PY. Gjatë këtyre takimeve a ju dha mundësia që të bëni
22 korrigjime dhe qartësime lidhur me këtë deklaratë?

23 PË. Po.

24 PY. A ju kujtohet që këto sqarime dhe këto korrigjime janë
25 shkruar në një shënim i cili më pas ju lexua juve?

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 11

1 PË. Po.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, Shënimi

3 Përgatitor numër 1 është DHT12068 deri në DHT12073.

4 PY. Duke marrë këto sqarime dhe korrigjime gjatë javës së
5 fundit dhe që ne i hodhëm në shënime, informacioni që keni
6 dhënë për dëshminë për Mbrojtjen e Thaçit a është e saktë dhe
7 i vërtetë me aq sa dini ju?

8 PË. Po.

9 PY. Duke marrë parasysh këto korrigjime dhe sqarime, të cilat
10 janë pasqyruar në shënim, informacioni që i keni dhënë
11 Mbrojtjes së Thaçit në dëshminë e dëshmitarit a pasqyron me
12 saktësi të njëjtat përgjigje që do i jepnit Gjykatës në qoftë
13 se do ju bëheshin të njëjtat pyetje, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne kërkojmë që
16 të pranohen në prova gjyqësore dëshmia e dëshmitarit që mban
17 numrin DHT11849 deri në DHT11864 dhe provat shoqëruese të
18 cilat janë pranuar në mënyrë provizore ose të përkohshme nga
19 Trupi Gjykues në vendimin F03452 dhe gjithashtu edhe Shënimi
20 Përgatitor DHT12068 deri në DHT12073.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
22 kundërshtime.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
25 kemi kundërshtime, dokumenti DHT11849 deri në 11864, DHT12068

1 deri në 12073 dhe të gjitha materialet shoqëruese sikurse u
2 renditën nga Mbrojtja pranohen në prova gjyqësore.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata e cila është
4 DHT11849 deri në DHT11864 do marri numrin e provës 1D00390,
5 aktualisht klasifikimi është konfidencial.

6 Shënimi përgatitor DHT12068 deri në DHT12073 do të marrë
7 numrin e provës 1D00391.

8 Sa i takon provave shoqëruese, dokumenti DHT05053 deri në
9 DHT05112 dhe faqet DHT05056 deri në DHT05057 do të marrin
10 numrin e provës 1D00392, klasifikimi është konfidencial.
11 Ndërkohë nga i njëjti numër faqesh, domethënë, që është
12 DHT05053 deri në DHT05112, faqet DHT05082 deri në DHT05084 do
13 të marrin numrin e provës 1D00393, klasifikimi është
14 konfidencial. Faqet nga i njëjti grup materialesh DHT05093
15 deri në DHT05096 do të marrin numrin e provës 1D00394,
16 klasifikimi është konfidencial. Ndërkohë, në të njëjtën numër
17 ose gamë faqesh DHT05098 deri në DHT05102 do të marrin numrin
18 e provës 1D00395. Klasifikimi është konfidencial. Nga i njëjti
19 material në faqet DHT05104 deri në DHT05104 do të marrin
20 numrin e provës 1D00396, klasifikimi është konfidencial. Dhe
21 përsëri nga i njëjti dokument faqet DHT05106 deri në DHT05108
22 do të marri numrin e provës 1D00397, klasifikimi është
23 konfidencial.

24 Në të njëjtin material faqet DHT05110 deri në DHT05110 do
25 të marri numrin e provës 1D00398, klasifikimi është

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 13

1 konfidencial.

2 Numri tjetër ERN është DHT5589 deri në DHT05591 që do të
3 marri numrin e provës 1D00399, klasifikimi është konfidencial.

4 Dhe dokumenti i fundit që është SPOE00203200 deri në
5 SPOE00203209 do të marrë numrin e provës 1D00400, klasifikimi
6 është konfidencial.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
8 arsye që këto dokumente të vazhdojnë të mbeten konfidenciale?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj që pjesa dërrmuese e tyre
10 mund të jenë publike, megjithatë pas pushimit të orës 10.00 do
11 t'ju them se cilat dokumentet do të vazhdojnë të qëndrojnë
12 konfidenciale dhe cilat mund të klasifikohen si publike.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
14 vazhdoni.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]
16 PY. Më 6 shator 2025, Mbrojtja e Thaçit ka dorëzuar një
17 përmbledhje të dëshmisë së dëshmitarit sipas rregullës 154 për
18 Trupit Gjykses dhe për të gjitha palët. Nuk kemi marrë asnjë
19 kundërshtim, kështu që kërkoj që të na jepni leje që ta
20 lexojmë këtë kundërshtim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 vazhdoni.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Covey ka shërbyer në Kosovë si
24 zëvendësi kryesor i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të
25 Përgjithshëm, Bernard Kouchner, në periudhën nga 15 korriku

1 1999 deri në janar 2001. Në këtë rol, Z. Covey ka luajtur një
2 rol shumë të rëndësishëm për zbatimin e mandatit të misionit
3 të Kombeve të Bashkuara në Kosovë që njihet ndryshe si UMNİK,
4 sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të
5 Bashkuara 1244 në Kosovë dhe ka punuar ngushtë me përfaqësues
6 vendorë me aktorë të ndryshëm, si dhe me figura politike në
7 Kosovë, përfshirë këtu dhe z. Hashim Thaçi.

8 Ai ka dhënë prova lidhur me rolin e z. Thaçi dhe punën që
9 ka bërë ai në bashkëpunim me UNMIK-un për të ndihmuar
10 stabilizimin e Kosovës duke folur kundër akteve të dhunës dhe
11 duke bërë thirrje për tolerancë, duke kryer kështu
12 demilitarizimin e UÇK-së dhe duke mbështetur krijimin e
13 shërbimit policor të Kosovës dhe Forcave Mbrojtëse të Kosovës
14 dhe duke marrë pjesë në përpjekje për të përfshirë
15 pjesëmarrjen lokale në qeverisje përmes Këshillit të
16 Përkohshëm të Kosovës dhe Strukturave të Administratës së
17 Përkohshme.

18 Konstatimet e tij e kanë bërë atë që të arrijë në
19 përfundimin që z. Thaçi nuk ka pasur autoritet real mbi
20 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe z. Thaçi nuk ka qenë në
21 qëndrim ose në pozicion që të organizojë ose të ndalojë dhunën
22 që ka ndodhur gjatë verës së vitit 1999, dhe se roli dhe
23 ambiciet e z. Thaçi ishin rol dhe ambicie të një politikani që
24 ka qenë i aftë për të punuar me UMNİK-un dhe ka qenë i aftë
25 gjithashtu dhe për të gjetur kompromis.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 15

- 1 Ky është fundi i përmbledhjes që kam për këtë dëshmitar.
- 2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
- 3 Z. MISETIC: [Përkthim]
- 4 PY. Z. Covey, për ta kuptuar, dëshmia që i keni dhënë
- 5 Mbrojtjes së Thaçit tanimë është pranuar në prova gjyqësore,
- 6 kështu që nuk na duhet që të përsërisim të gjitha pyetjet që
- 7 kemi për ju. Tani do t'ju bëj disa pyetje të tjera plotësuese
- 8 kryesisht për gjëra të cilat nuk janë cekur plotësisht në
- 9 dëshminë tuaj. A e kuptoni këtë gjë?
- 10 PË. Po, e kuptoj.
- 11 PY. Në paragrafin 79 të deklaratës tuaj ju thoni:
- 12 "Unë nuk e kam parë asnjëherë z. Thaçi që ka pasur
- 13 kompetencë ose ndikim të përnjëmend mbi UÇK-në. Ky konstatim
- 14 mbështetur jo vetëm në raport e nga burime shumë të besuara
- 15 por dhe nga fakti që kam parë me sytë e mi izolimin e Thaçit
- 16 në praninë e personave të fortë të UÇK-së, persona të cilët
- 17 kishin vërtetë kompetencë në UÇK."
- 18 Në Shënimin Përgatitor numër 1, në paragrafin 10, ju
- 19 thoni që këto burime shumë të besuara përfshijnë edhe
- 20 Gjeneralin Sir Mike Jackson. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?
- 21 PË. Po.
- 22 PY. Në paragrafin 61 dhe 62 të dëshmisë tuaj, juve diskutoni
- 23 një takim në shtator të 1999-s, ku Gjenerali Clark fluturoi në
- 24 drejtim të Kosovës për të përdorur autoritetin e vet për të
- 25 ndihmuar për të bindur komandantët rajonalë të UÇK-së për t'u

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 16

1 pajtuar me plotësimin e kërkesave për demilitarizim të UÇK-së.

2 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar? Ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

3 PË. Po, më kujtohet.

4 PY. Në paragrafin 62, ju thoni që kjo ishte hera e parë që ju

5 dhe z. Kouchner e shikonit z. Thaçi me komandantët e zonave në

6 të njëjtën hapësirë, në të njëjtin vend. A ju kujtohet kjo,

7 Dëshmitar?

8 PË. Po, më kujtohet.

9 PY. Në Shënimin Përgatitor 1 në faqen 4, në paragrafin 10(r),

10 ju shpjegoni një vizatim ose një pikturë që gjendet në librin

11 e Gjeneralit Jackson.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të

13 paraqesë në ekran këtë pikturë, që është SPOE00212586 deri në

14 00212696, konkretisht dëshiroj që të paraqitet në ekran

15 SPOE00212620.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se

17 më lejoni, është një provë që ka një numër P2521.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Me sa e kuptoj unë faqja që kërkoj

19 unë që të shfaqet në ekran nuk është pjesë e provave të

20 pranuar nga Prokuroria.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, po, është. Ky është numri i

22 provës.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Prokurores.

24 Dhe do i kërkoj Sekretarit tani që të përdorë numrin e

25 provës që përmendi kolegja që është P2521.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 17

1 PY. Z. Covey, ju kujtohet kjo fotografi?

2 PË. Po.

3 PY. A keni marrë pjesë në ndonjë mënyrë në përgatitjen e
4 kësaj pikturë?

5 PË. Po.

6 PY. Në çfarë mënyre keni marrë pjesë?

7 PË. Artisti më tregoi pikturën të cilën ishte duke e bërë
8 sepse synonte të më fuste dhe mua në atë pikturë. Në fakt, më
9 kishte pikturuar. Unë jam aty menjëherë në të majtë pas Çekut,
10 pra, me kollare të verdhë. Edhe i kërkova atij që të
11 pikturonte aty shefin e policisë që ishe i sëmure në atë kohë
12 dhe nuk mori pjesë në këtë takim, që është pikturuar këtu,
13 sepse shefi i policisë ishte funksionar i rëndësishëm dhe
14 mendova që duhet të ishte pjesë e kësaj. Artisti e bëri këtë
15 punë dhe, sipas kërkesës time, më pikturoi në mënyrë më pak të
16 dukshme mua se nuk më pëlqen shumë të shfaqem para kamerave.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim pjesën e sipërme të faqes
18 ju lutem. Zmadhojmë cepin ku është ajo fotografia. Po, këtu.

19 PY. Personi në këtë fotografi në pjesën e djathtë në cep
20 sipër, a e njihni këtë person?

21 PË. Personi afër dorës së tij ku është duke pikturuar është
22 Mike Jackson.

23 PY. Jo. E kam fjalën personi në fotografi në pjesën e sipërme
24 të djathtë, jo në pikturë po në faqe.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund ta zmadhojmë pak

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 18

- 1 më shumë për dëshmitarin dhe zhvendosim pak në anën e djathtë.
- 2 PY. Pra, personi me këmishë ngjyrë blu?
- 3 PË. Ky duhet të jetë Bernard Kouchner.
- 4 PY. Jo, jo. Pjesa e sipërme, në pjesën fare të djathtë
- 5 personi që duket që po pikturon, pra, në pikturë.
- 6 PË. Nuk më kujtohet tanimë emri i tij.
- 7 PY. Kush ishte ky?
- 8 PË. Po flasim për personin me flokë të gjata me këmishë
- 9 ngjyrë blu?
- 10 PË. Po.
- 11 PY. Mesa e di unë, ai erdhi aty vetëm me leje të KFOR-it për
- 12 të bërë këtë pikturë.
- 13 PY. Pra është artisti?
- 14 PË. Po, artisti.
- 15 PY. Shohim aty që ai ka fotografi të personave të ndryshëm
- 16 aty afër kanvasit, pra, pjesës ku do pikturojë. A i ke parë
- 17 këtë gjë në kohën kur ishit aty?
- 18 PË. Jo. Unë kam parë thjesht pikturën që ishte duke u
- 19 pikturuar sepse donte që të më përfshinte dhe mua.
- 20 PY. Në Shënimin Përgatitor 1, faqja 4, paragrafi 10, ju
- 21 shpjegoni që në këtë pikturë paraqitet një skenë e zakonshme e
- 22 Këshillit për Implementim, për Zbatim, pra, po jo takimi,
- 23 mbledhja e fundit që përfshinte z. Thaçi të cilin ju e keni
- 24 diskutuar në paragrafin 62 të deklaratës tuaj?
- 25 PË. Po. Kjo është e saktë. Kjo është një prej mbledhjeve,

1 takimeve të zakonshme kryesuar nga Gjenerali Jackson për të
2 zhvilluar më tej dhe saktësuar detajet dhe hollësitë e
3 zbatimit të marrëveshjes.
4 PY. Dhe në të njëjtin paragraf të Shënimit Përgatitor 1, ju
5 deklaroni që përveç me përjashtim të takimit të mbledhjes së
6 fundit, nuk jeni i sigurtë që z. Thaçi të ketë marrë pjesë në
7 takime të tjera të Këshillit për Zbatim edhe pse të dhënat apo
8 dosjet e UÇK-së mund të tregojnë që ai ka marrë pjesë në disa
9 prej tyre? Është e saktë kjo?

10 PË. Kjo është e saktë. Kam marrë pjesë në disa prej këtyre
11 mbledhjeve përgatitore dhe nuk më kujtohet të kem parë z.
12 Thaçi të pranishëm në ndonjë prej këtyre mbledhjeve.

13 PY. Tani në qoftë se mund të tregojmë pikturën, të shfaqim
14 pikturën ju lutem dhe na tregoni kush është i ulur në pozitat
15 e ndryshme, në vendet e ndryshme që janë aty?

16 PË. Tani sipas akrepave të orës rreth tavolinës, personi me
17 këmishë të bardhë është këshilltari politik.

18 PY. Këshilltari politik i kujt?

19 PË. Këshilltari politik i Gjeneralit Jackson, Mike Jackson.

20 Oficeri në të majtë të tij, nuk më kujtohet emri. Pastaj
21 Mike Jackson është aty. Vazhdojmë rreth tavolinës, kemi
22 Bernard Kouchner, pastaj shefi i policisë, pastaj unë dhe
23 pastaj z. Çeku. Dhe pastaj nuk më kujtohet kush është oficeri
24 i UÇK-së në të djathtë fare.

25 PY. UÇK-ja zakonisht uleshin përballë Gjeneral Jackson, apo

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 20

1 jo, përfaqësuesit e UÇK-së?

2 PË. Po.

3 PY. Gjeneral Çeku zakonisht ulej përballë Gjeneral Jackson
4 dhe komandantë të tjerë rajonalë uleshin jashtë fotografisë në
5 të majtë, në të majtë të Çekut.

6 PY. Në të majtë apo në të djathtë?

7 PË. Në të djathtë, ju kërkoj ndjesë.

8 PY. Do t'ju kërkoja tani që të shënoni në ekran, me ndihmën e
9 asistentes, ku është ulur z. Thaçi në mbledhjen e fundit në të
10 cilën ka marrë pjesë?

11 Asistentja do t'ju ndihmojë.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Duhet ta heqim këtë
13 dokument besoj?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë se nuk jam artist,
16 për të shënuar, pikturuar, po do përpiqem të bëj më të mirën.

17 Në krye të dhomës ishte një si podium aty, pastaj ku
18 është ulur Gjenerali Jackson dhe Wesley Clark dhe disa oficerë
19 të tjerë të KFOR-it.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. A mund të shënoni me numër 1 këtë pjesë?

22 PË. [Shënon]

23 PY. Po.

24 PË. Pastaj ishte një tavolinë këtu ku ishin ulur disa
25 personalitete, të ngjashëm që ishin me atë paraqitur në

1 pikturë, pra, Bernard Kouchner. Zëvendësshefi i policisë nuk
2 ka qenë aty. Unë kam qenë aty dhe më kujtohet në qoftë se ka
3 patur një përfaqësues tjetër të UMNİK-ut të tretë aty.

4 PY. Mund ta shënoni me numrin 2 këtë tavolinë?

5 PË. [Shënon]. Pastaj këtu kishte karrige që paloseshin. Dhe
6 mesa më kujtohet, Çeku, aq sa më kujtohet, ai ishte i ulur
7 këtu. Pastaj gjithë kjo pjesë, pra, ku ishin karriget ishin
8 ulur komandantët rajonalë.

9 PY. Kjo pjesa me komandantët rajonalë që ju e keni shënuar
10 këtu me pika-pika, vija të ndërprera, ishin komandantët
11 rajonalë?

12 PË. Po, sepse ishin në karrige, nuk ishin në tavolinë.

13 PY. Ju lutem shënojeni me numër 3.

14 PË. [Shënon]. Pastaj këtu kishte dhe këtu karrige, ku ishte
15 ulur z. Thaçi me një ose dy persona tjerë përveç komandantëve
16 anash në një distancë nga komandantët.

17 PY. A mund ta shënoni me numër 4 këtë pjesë?

18 PË. [Shënon]

19 Z. MİSETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, propozoj që të bëjmë
20 një fotografi të kësaj dhe unë e paraqes këtë për pranim në
21 prova.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
23 kundërshtim?

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fotografia e

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 22

1 bërë e këtij vizatimi shënohet si provë materiale dhe
2 pranohet.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të më duhet një çast
4 që të ruaj dokumentin, të nderuar Gjykatës. Faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Z. Gjykatës, a më lejohet të kem
7 një fletore dhe një stilolaps që të mbaj shënime sepse me
8 kohën që kalon kujtesa është pak e dobët?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi
10 kundërshtime. Pra, mund t'ju jepen këto, por nuk keni të
11 drejtë që të largoheni me to nga salla e gjyqit.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur të
14 mbaroni ato shënime që do merrni do të prishen, pra, do t'i
15 hedhim poshtë.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Vizatimi që u bë nga
18 dëshmitari merr numrin e provës materiale 1D200401

19 Mund të na e sqaroni për sa i përket klasifikimit?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
22 Riklasifikohet si publike.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 1D00401
25 pranohet.

1 Vazhdoni.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Kryetar.

3 PY. Z. Covey, a mori pjesë z. Thaçi në diskutimet në ndonjë
4 mënyrë në takimin e fundit?

5 PË. Jo. Mesa më kujtohet, ai nuk la ndonjë përshtypje në atë
6 kohë, nuk mori pjesë. As nuk i ishte kërkuar që të bënte një
7 gjë të tillë dhe as nuk u paraqitë në mënyrë vullnetare, pra,
8 nuk propozoi që ta bënte.

9 PY. Kush foli në takimin në emër të UÇK-së?

10 PË. Gjeneral Çeku.

11 PY. A patë komandantë të tjerë të UÇK-së që biseduan me z.
12 Thaçi?

13 PË. Jo. Dhe ndoshta mund të them diçka lidhur me këto më në
14 hollësi.

15 PY. Vazhdoni.

16 PË. Kjo më kujtohet fare qartë sepse, në fakt, dukej sikur po
17 konfirmonte fuqishëm atë që ne besonim që në fillim lidhur me
18 z. Thaçi kur jemi njohur me të, pra, që ai kishte një
19 marrëdhënie të ndërlikuar me komandantët në terren,
20 komandantët e UÇK-së dhe se ata kishin pak kohë, ose më mirë
21 thënë, kishin shfaqur mungesë respekti ndaj tij, s'kishin
22 respekt për të. Pra, në këtë rast për të cilin po flasim, po
23 të shohim këtë vizatim -- po më lejoni të kthehem pak mbrapa,
24 në qoftë se --

25 PY. Sigurisht.

1 PË. Pra, Gjenerali Jackson, i cili kishte mospajtim, pra, me
2 Gjeneralin Clark për sa i takon përpjekjeve të rusëve për të
3 marrë aeroportin përpara se KFOR-i të hynte në Kosovë dhe unë,
4 Gjenerali Clark dhe Gjenerali Jackson dhe, është meritë e tyre
5 kjo, kishin tejkaluar këtë mosmarrëveshje serioze. Dhe kur
6 Gjenerali Jackson pati nevojë që të sillte komandantët e UÇK-
7 së t'i kalonte aty dhe t'i rivendoste, t'i bindte ata që të
8 pranonin kushtet e pranimin të marrëveshjes, konkretisht
9 marrëveshjet për krijimin e Forcës së Mbrojtëse së Kosovës, si
10 organizatë civile e paarmatosur KFOR-i ishte afër afatit kohor
11 që ishte dhënë, dhe duhej ndihmë për të bindur komandantët që
12 të jepnin një përgjigje pozitive sepse afati kohor po afrohej.
13 Gjenerali Clark bëri një prezantim shumë të fuqishëm, të
14 zgjatur dhe të gjerësishëm lidhur me rëndësinë e legjendës së
15 Cincinnatus dhe biles hoqi dhe xhaketën e tij, i cili hoqi
16 xhaketën e tij që ishte i paarmatosur dhe ju nënshtrua
17 kontrollit civil.

18 Në fund të paraqitjes, prezantimit të Welsey Clark
19 Gjenerali Jackson bëri një pushim dhe njerëzit morën ndonjë
20 pije, pushuan. Të gjithë ishin aty, përveç z. Thaçi i cili
21 qëndroi, po lëviznin, merrnin diçka ndërsa z. Thaçi qëndroi
22 aty ku ishte. Dhe komandantët e tjerë po bisedonin me njëri-
23 tjetrin nëse flisnin anglisht, ata që dinin anglisht dhe po
24 bisedonin me Gjeneralin Clark. Dhe unë, me qëllim nuk
25 shkëmbeva, nuk pata shkëmbime me z. Thaçi, as nuk kam shikuar

1 në drejtim të tij. Si vëzhgues m'u duk se sjellja e tyre ishte
2 përçmuese ndaj tij. Dhe isha shumë i çuditur, i habitur. Por,
3 në fakt, në të njëjtën kohë kjo më solli në kujtesë atë që ne
4 besonim që prej fillimit, që z. Thaçi në të vërtetë nuk kishte
5 marrëveshje të njëmenda ose të rëndësishme me këtë trup të
6 komandantëve në terren dhe që kishte shumë pak gjasa që ata të
7 kërkonin udhëzimet e tija, aq më pak urdhrat e tij apo që të
8 raportonin për aktivitete t e tyre tek ai.

9 PY. Në vijim të kësaj si e keni kuptuar ju në atë kohë arsyen
10 pse komandantët rajonalë apo komandantët e zonave duhej të
11 flisnin me Gjeneralin Clark, pse nuk kanë biseduar me
12 Gjeneralin Çeku ose me z. Thaçi, a keni kuptuar ju që
13 komandantët e zonave duhet të flisnin me Komandantin Suprem të
14 NATO-s?

15 PË. Ashtu siç e kemi kuptuar në atë kohë nuk ka patur komandë
16 qendrore. Gjeneral Çeku ishte individ i më me ndikim në UÇK dhe
17 kjo është me më shumë ndikim se të tjerët, por megjithatë nuk
18 duhej të ishte në një pozitë të tillë që të fliste, të merrte
19 përsipër këtë dhe kishte nevojë të dinte që kishte marrëveshje
20 midis tyre, pra, që kishte pajtim. Dhe gjatë takimit, ne mund
21 të shihnim Gjeneral Çekun, shumë të qetë, i cili shikonte
22 prapa për të kontrolluar, verifikuar dhe siguruar që
23 komandantët e mbështesnin, mbështesnin hollësitë që po
24 diskutoheshin, hollësitë e marrëveshjes, detajet.

25 Pra, neve na dha përshtypjen se Çeku duhej, kishte nevojë

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 26

1 të dinte të sigurohej që kishte konsensus që merrte, pra,
2 mbështetje nga komandantët në terren. Dhe kjo ishte tërësisht
3 në përputhje me atë që kuptonim ne, sepse ne kuptonim që UÇK-
4 ja ishte më shumë një lëvizje sesa një ushtri ku secili
5 individ në zonë apo komandant në terren kishte një autonomi të
6 gjerë, ndërsa në realitet -- qoftë kjo në realitet apo në
7 imagjinatën e tyre. Ata kishin këtë autonomi në terren e këtë
8 pushtet. Ata mendonin që mund të bënin atë që vendosnin të
9 bënin në zonë e tyre, pra, se ishin të pavarur. Kjo ishte
10 mënyra sesi ne e kemi kuptuar këtë.

11 PY. Faleminderit. Z. Covey

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja të kalojmë tek një temë
13 tjetër. Z. Sekretar, na shfaqni në ekran ju lutem DHT05465
14 deri në DHT05471.

15 PY. Z. Covey, që t'ju orientojmë ky është kabllogram i UMNİK-
16 ut i datë 5 korrik nga Sergio De Mello. E di që kjo është
17 dhjetë ditë përparësisht përpara arritjes tuaj në Kosovë, por
18 megjithatë duhet të kalojmë në faqen DHT05466.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek pika 1.

20 PY. Aty shohim pra, që është një raport ku thuhet:

21 "PSSP-ja e informoi se ai i kishte transmetuar Thaçit,
22 komunikuar Thaçit protestimin e Bishopit Artemije dhe z.
23 Trajkovic lidhur me incidentet natën e 2 korrikut. Thaçi ishte
24 distancuar nga këto incidente dhe kishte ofruar të jepte një
25 komunikatë publike, deklaratë publike lidhur me këtë."

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 27

1 Kalojmë në faqen tjetër DHT05467, pjesa "Përfundim", ku
2 thuhet:

3 "Thaçi, gatishmëria e Thaçit përbën një deklaratë publike
4 ku në të cilën distancohet nga ngjarjet e 2 korrikut, largoi,
5 hoqi, zhvlerësoi argumentin e serbëve për të mos punuar më me
6 shqiptarët e Kosovës. Pra, duke lënë retorikën me një anë, ata
7 dukej se ishin të gatshëm të merrnin pjesë në Këshillin
8 Tranzitor të Kosovës."

9 Ky shënim a përputhet me atë që ju kujtohet juve në
10 përgjithësi sa i takon qasjes së Thaçit ndaj kundrejt dhunës
11 etnike?

12 PË. Po. Ne mund të diskutojmë takimin e parë dhe të dytë të
13 Këshillit Tranzitor ku kemi qenë vetë dëshmitarë. Natyrisht,
14 ky raport në veçanti është bërë përpara arritjes tonë,
15 shkuarjes tonë atje, por është përputhet me atë që kemi
16 vëzhguar më vonë lidhur me sjelljen publike, qëndrimin publik
17 të z. Thaçi.

18 PY. Faleminderit.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, paraqes këtë dokument
20 për pranim si provë, DHT05465 deri në DHT05471.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
22 kundërshtim?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT05465 deri
25 në 05471 pranohet.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 28

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument do të marrë
2 numrin e provës materiale 1D0040 dhe klasifikimi është
3 konfidencial.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publik.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
6 Riklasifikohet si publik.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem të shfaqni
9 në ekran dokumentin DHT01307 deri në DHT01308.

10 PY. Z. Covey, ky është informim mbi gjendjen në terren i
11 OSBE-së i datës 10 korrik 1999.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe tani do kërkoj të kalojmë në
13 faqen tjetër.

14 PY. Dhe do të lexoj një pjesë dhe t'ju bëj një pyetje. Ky
15 raport, këtu raportohet mbi diçka që ka ndodhur më datën 9
16 korrik. Titulli është "Autoritetet shqiptare në Kosovë dënojnë
17 hyrjet e palejuara në banesat e serbëve".

18 "Bordi i Autoritetit Vendor i Qeverisë së Përkohshme
19 tranzitore shqiptare të Kosovës i udhëhequr nga Hashim Thaçi u
20 takua me kryesuesin e 25 komunave të Kosovës të caktuar,
21 emëruar si kryesues të autoritetit shqiptar pas hyrjes së
22 trupave të KFOR-it në Kosovë.

23 "Ata dënuan hyrjet e palejuara, të paligjshme nga
24 shqiptarët etnikë në apartamentet, banesat dhe shtëpitë e
25 serbëve."

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 29

1 A përputhet kjo me atë që keni kuptuar ju në atë kohë të
2 qasjes lidhur me qasjen e Thaçit sa u takon tensioneve etnike
3 pas konfliktit?

4 PË. Po. Kjo ka qenë përpara se të arrinim ne dhe na ka sjellë
5 në vëmendje, pra, e kemi mësuar këtë gjë vetëm më vonë, por
6 përputhet me përshtypjen që kishim ne të qasjes që z. Thaçi
7 kishte dhe shfaqte me kalimin e kohës.

8 PY. Faleminderit.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. kryetar, paraqes këtë dokument
10 për t'u pranuar si provë DHT01307 deri në DHT01308.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
12 kundërshtim?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT01307 deri
15 në 01308 pranohet.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument do të marrë
17 numrin e provës materiale 1D00403. Dhe në qoftë se mund të
18 kemi më shumë sqarime për klasifikimin.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbetet konfidencial.

20 Do t'i kërkoj, Sekretarit të Gjykatës tani të shfaqë në
21 ekran provën materiale 1D00361. Në qoftë se mund të kalojmë
22 tani në faqen tjetër.

23 PY. Z. Covey, ky duket të jetë një memorandum i UNMIK-ut i
24 datës 5 tetor 1999. Është dërguar nga Bernard Kouchner kemi
25 inicialet e tij afër emrit të tij. I njihni këto inicialet?

1 PË. Po. Siç mund ta shihni përpara emrit të tij kemi një
2 shkarravitje që është "katër", pra, janë inicialet e mia që i
3 kam vënë në vend të atij. E kemi bërë shpesh këtë lidhur me
4 gjëra që kuptoheshim mes nesh dhe nuk ishte e nevojshme që të
5 ndiqej gjithë vija burokratike që ai të nënshkruante gjithçka
6 dhe çdo gjë. Unë shënoja se do përmendja tani, meqë m'u dha
7 mundësia, që kemi bërë çdo përpjekje të mundur që të trajtonim
8 rolin e zëvendësit të parë si *tandem*, si binom pra, i PSSP-së
9 dhe jo thjesht si një kuti përmes së cilës duhet të shkonin
10 gjërat.

11 PY. Në qoftë se shohin paragrafin e parë, thotë:

12 "Zyrat UNMIK-ut në të gjitha nivelet kanë marrë
13 komunikime me shkrim nga e ashtuquajtura 'Qeveri e Kosovës'
14 apo 'Qeveri e Përkohshme e etniteteve të Kosovës'. Politika e
15 misionit ka qenë që këto letra t'i kthehen mbrapsht dërguesit
16 pa përgjigje, pasi misioni nuk do që të vihet në pozicionin ku
17 pranon dhe njeh këto entitete. Kjo politikë nuk kufizon
18 kontaktet apo nuk parandalon kontaktet e përditshme të cilat
19 pjesëtarë të stafit të UNMIK-ut -- kontakte që pjesëtarë të
20 stafit të UNMIK-ut kanë me përfaqësuesit e kësaj qeverie të
21 ashtuquajturës qeveri apo entiteteve."

22 Tani në këtë memorandum thuhet që kjo ka qenë politika e
23 UNMIK-ut që këto letra t'i kthehen dërguesit nëse ato vinin
24 nga qeveria e Kosovës apo Qeveria e Përkohshme e Kosovës. A ju
25 kujtohet nëse kjo politikë ka qenë e zbatueshme në/ose rreth

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 31

1 qershorit 1999 kur keni arritur ju?

2 PË. Besoj që po. Ky ka qenë synimi dhe qëllimi jonë. Dhe
3 besoj që i kemi kthyer këto letra mbrapsht në çdo rast që ato
4 kanë ardhur, por nuk do të habitesha në qoftë se janë bërë
5 gabime gjatë këtij procesi, por synimi jonë, qëllimi jonë ka
6 qenë që t'i kthenim këto pa komente me qëllim që në fakt ne të
7 mos prananim përmes këtij komunikimi ekzistencën e Qeverisë së
8 Përkohshme të Kosovës.

9 PY. Në bazë të kësaj, bazuar në këtë politikë, UNMIK-u a
10 pranonte dokumente dërguar nga z. Thaçi nëse ai e nënshkroi
11 atë si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës apo
12 UNMIK-u i kthente këto mbrapsht si pjesë e politikës së saj?

13 PË. Si pjesë e politikës. Kërkoj ndjesë. Dua të ngadalësoj.
14 Pra, si pjesë e politikës ne duhet t'i kthenim mbrapsht.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar shoh se ora ka ardhur
17 për pushim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Covey, do
19 t'ju japim dhjetë minuta pushim.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi pas
22 dhjetë minutash.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 32

1 ndërpritet deri në orën 10.10 minuta.

2 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

3 --- Seanca rifillon në orën 10.11

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të tregoni
6 tani se çfarë do të pranojmë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, ne besojmë që të gjithë provat
8 tona materiale mund të jenë publike, me përjashtim të 1D394,
9 1D395, të cilat duhet të mbeten konfidenciale me kërkesë të
10 ofruesit të informacionit, sipas rregullës 107, dhe po presim
11 të dëgjojmë nga ZPS-ja lidhur me qëndrimin e tyre, lidhur me
12 provën 1D397, nëse duhet të jetë konfidenciale.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do të mund të bëhet publike.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, të dy provat që do të
15 jenë konfidenciale, 1D394, 1D395.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha
17 provat materiale të shoqëruara me përjashtim të 1D394 dhe D395
18 do të riklasifikohen si publike. Të tjerat do të mbeten
19 konfidenciale.

20 Znj. Sekretare, të sjellim dëshmitarin në sallë.
21 Faleminderit.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
24 mund të vazhdoni.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 33

1 PY. Z. Covey, ju bëra disa pyetje më herët lidhur me takimin
2 e fundit të Komitetit të Përbashkët dhe ju pyeta lidhur me
3 marrëdhëniet mes Gjeneralit Çeku dhe z. Thaçi.

4 A e keni -- sipas mendimit tuaj, a ishte shefi i Çekut z.
5 Thaçi?

6 PË. A e mendova unë që z. Thaçi ishte shefi i z. Çeku?

7 PY. Po.

8 PË. Absolutisht jo.

9 PY. Përse thoni absolutisht jo, pse jeni kaq i sigurt?

10 PË. Sipas asaj që i kam parë, ata silleshin në mënyrë
11 korrekte njëri me tjetrin. Nuk më kujtohet qartë nëse kanë
12 shkëmbyer fjalë njëri me tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë.
13 Sigurisht asnjëherë nuk e kam parë njërin që t'i jepte urdhër
14 apo udhëzime tjetrit. Dhe më dukej sikur silleshin me rezerva
15 njëri me tjetrin. Dhe sipas përvojës sonë, rrallëherë i kemi
16 parë në të njëjtën dhomë së bashku.

17 PY. I keni parë në të njëjtin vend të paktën një herë, në
18 këtë takim të fundit të këtij Komitetit të Përbashkët, aty ku
19 ishte dhe Gjenerali Clark, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. A e keni parë nëse Gjenerali Çeku të jetë konsultuar me
22 z. Thaçi?

23 PË. Jo.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të kalojmë në provën
25 materiale P880?

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 34

1 PY. Z. Covey, a e keni parë më parë këtë letër që është në
2 ekran?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të shikojmë edhe fundin
4 e kësaj faqeje.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Është letër që thuhet që është dërguar nga Hashim Thaçi,
8 komandant i përgjithshëm i UÇK-së, që i është dërguar Bernard
9 Kouchner, në bazë të marrëveshjes së çarmatosjes së UÇK-së në
10 21 qershor 1999, që është mes komandantit të KFOR-it dhe UÇK-
11 së, ku i kërkohej që të lejoheshin disa pjesëtarë të UÇK-së që
12 të mbanin "armë brezi". A të kujtohet kjo letër?

13 PË. Po.

14 PY. Në atë kohë, a e keni menduar që z. Thaçi ishte komandant
15 i përgjithshëm i UÇK-së?

16 PË. Jo. Unë flas në emër të UNMIK-ut. UNMIK-u nuk e ka
17 trajtuar atë si komandant.

18 PY. Pas kësaj letre, a keni pasur bisedë lidhur me të, lidhur
19 me këtë letër me z. Thaçi?

20 PË. Jo.

21 PY. Z. Thaçi, me sa dini ju, a e ka ndjekur më tej me
22 UNMIK-un këtë kërkesë që ka bërë?

23 PË. A mund të komentoj?

24 PY. Vazhdoni.

25 PË. Diplomatat dhe burokratët shpeshherë janë, kanë dijeni

1 për nevojën që duhet t'i shërbejnë një interesi të caktuar,
2 dhe në atë kohë, dhe më duket se e kam diskutuar me Bernard
3 Kouchner këtë letër, pasi e morëm këtë letër. Dhe m'u duk se
4 kjo ishte thjesht një gjest, që ishte një interesin e tij që
5 ta dërgonte këtë letër, thjesht.

6 Ai nuk ka bërë asnjë koment lidhur me urgjencën apo jo të
7 kësaj kërke. Nuk e ka përmendur më asnjë herë tjetër, nuk u
8 përpoq që ta shfrytëzonte mundësinë që ka pasur për
9 bashkëpunim në çështje të tjera për t'iu kthyer kësaj
10 çështjeje. Pra, thjesht m'u duk se po shfrytëzonte rastin për
11 t'i shërbyer një interesi tjetër.

12 PY. UNMIK-u i është përgjigjur kësaj pyetjeje, kësaj kërke,
13 me sa dini ju?

14 PË. Me sa di unë, jo. Dhe mund të them qartë se kjo ishte
15 jashtë tërë mandatit tonë, nuk mund të ishim në -- nuk mund të
16 ishte në mandatin tonë kjo. Ishte çështje e KFOR-it. Por jo,
17 ne nuk jemi përgjigjur.

18 PY. Faleminderit. I kthehem një teme tjetër tani. Në kohën
19 kur keni shërbyer në Kosovë, çfarë -- cila ishte data kur ka
20 përfundu konflikti mes forcave të UÇK-së dhe forcave serbe?

21 PË. Sipas nesh, konflikti përfundoi me marrëveshjen me serbët
22 për t'u tërhequr, që më duket se është nënshkruar më datë 20
23 qershor. Nuk më kujtohet, thjesht po -- ekziston dokumenti.
24 Dhe zbatimi i këtij dokumenti i dha fund në mënyrë zyrtare dhe
25 konfliktit.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 36

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, të vendosim në ekran
2 P02563, në faqen 24, që ka shifrën, numrin e provës
3 SPOE00000772. Faqen e parë për t'i treguar dëshmitarit se
4 çfarë dokumenti është ky.

5 PY. Është një raport për Këshillin e Sigurimit nga Sekretari
6 i Përgjithshëm, e ka datën 12 qershor 1999, që është në vijim
7 të paragrafit 10 të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen 24.

9 PY. Në paragrafin 88 në krye, Sekretari i përgjithshëm
10 raporton -- në fakt përpara se sa ta bëj këtë pyetje. Raportet
11 që Sekretari i Përgjithshëm i dërgonte Këshillit të Sigurimit,
12 a përgatiteshin nga UNMIK-u?

13 PË. Po. UNMIK-u përgatiste raportin e vet i cili shfrytëzohej
14 për raportin e Sekretarit të Përgjithshëm.

15 PY. Atëherë, paragrafi 88, ku thuhet që:

16 "Një problem akut i veçantë për të drejtat e njeriut në
17 Kosovë është paqartësia lidhur me vendndodhjen e anëtarëve të
18 familjes të cilët janë zhdukur gjatë konfliktit. Kanë ndodhur
19 rrëmbime pas konfliktit".

20 Data është 12 korrik 1999. A përputhet kjo me atë që keni
21 kuptuar ju në Kosovë në atë kohë që konflikti kishte
22 përfunduar më datën 12 qershor 1999?

23 PË. Po.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar, a mund të vendosim
25 provën materiale 1D254?

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 37

1 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të shtoj që punës sonë ne
2 gjithmonë i jemi referuar si punë zhvilluar pas përfundimit të
3 konfliktit?

4 Z. MISETIC: [Përkthim]

5 PY. Faleminderit. Z. Covey, kjo është një rregullore e
6 UNMIK-ut e lëshuar më 21 dhjetor të vitit 2000. Në atë kohë
7 keni qenë ende në post atje, apo jo?

8 PË. Po.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në paragrafin 1.5 -- në
10 fakt përpara se ta bëjmë një gjë të tillë më lejoni të lexoj
11 titullin me qëllim që të orientohemi. Është një rregullore e
12 UNMIK-ut që ka të bëjë me përfitimet për invalidët e luftës në
13 Kosovë dhe për të afërmit e atyre që kanë vdekur si rezultat i
14 konfliktit të armatosur në Kosovë. Të kalojmë tani në
15 paragrafin 1.5.

16 PY. Rregullore thotë që:

17 "Për synimet e rregullores aktuale, konflikti i armatosur
18 në Kosovë ka ndodhur nga 27 shkurti 1998 deri më 20 qershor
19 1999."

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, të vendosim në ekran
21 1D00255.

22 PY. Kjo është një rezolutë -- rregullore e lëshuar në vitin
23 2006, pra pas largimit tuaj nga Kosova, dhe në këtë, dhe kjo
24 është rezolutë lidhur me kërkesat që kanë të bëjnë me pasuritë
25 e paluajtshme private, përfshirë pasuritë bujqësore dhe

1 komerciale, apo tregtare.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të kalojmë në paragrafin 3.1,
3 ku thuhet:

4 "Agjencia e Pronave në Kosovë përmes Sekretarit Ekzekutiv
5 do të ketë kompetencë për të marrë dhe për të regjistruar dhe
6 përveç Komisionit të Kërkimit të Pronave, të ketë kompetenca
7 për të zgjidhur pas ushtrimit të drejtës së apelit në Gjykatën
8 Supreme të Kosovës, kategoritë vijuese që kanë të bëjnë ose
9 kanë çuar në konflikte që kanë të bëjnë me rrethana që
10 rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga konflikti i armatosur
11 që ndodhi mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999".

12 Z. Covey, a vendosi vetë UNMIK-u faktin që konflikti i
13 armatosur në Kosovë përfundoi më datën 20 qershor 1999?
14 PË. Po.

15 PY. A keni pasur dijeni lidhur me ndonjë përleshje të
16 armatosur mes forcave të UÇK-së dhe forcave serbe pas 20
17 qershorit 1999?

18 PË. Unë nuk kam dijeni lidhur me ndonjë përleshje e cila të
19 mund të quhej përleshje ushtarake.

20 PY. A keni dijeni për ndonjë përleshje?

21 PË. Jo. Por nuk përjashtoj mundësinë që të ketë pasur ca
22 fërkime. Por asgjë nuk na është treguar neve apo raportuar tek
23 ne.

24 PY. A keni pasur dijeni lidhur me ndonjë, me lëndime apo të
25 vdekur mes forcave të UÇK-së dhe forcave serbe mbas 20

1 qershorit 1999?

2 PË. Jo.

3 PY. A ka patur ndonjë qytet në Kosovë apo fshat që të jetë
4 rrethuar nga forcat e armatosura pas 20 qershorit 1999?

5 PË. Jo. Ndoshta më duhet të them unë kam dijeni të paktën.

6 PY. A është bllokuar ndonjë rrugë nga forcat e armatosura pas
7 20 qershorit 1999?

8 PË. Jo, për sa kam dijeni unë.

9 PY. Në Kosovë, a është gjuajtur me armë të rënda pas 20
10 qershorit 1999?

11 PË. E përsëris, jo me sa kam dijeni unë.

12 PY. A keni dijeni lidhur me civilët që janë larguar nga zonat
13 e luftës, apo që të ketë pasur viktima civile si rezultat i
14 përleshjes së forcave të UÇK-së dhe forcave serbe pas 20
15 qershorit 1999?

16 PË. Jo, nuk kam dijeni.

17 PY. A keni dijeni lidhur me ndonjë deklaratë apo rezolutë të
18 Këshillit të Sigurimit që të shprehë shqetësim lidhur me
19 vazhdimin e luftimeve të armatosura në Kosovë pas 20 qershor
20 1999?

21 PË. Jo.

22 PY. Faleminderit, z. Covey.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani duhet t'i kthehem provës
24 materiale P01980.

25 PY. Në ekran, z. Covey, është një kabëll i koduar që është

1 dërguar nga z. Kouchner, e ka datën 21 korrik 1999, e ka të
2 bëjë me takimet politike.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen pasuese, në
4 pjesën e parë.

5 PY. Dhe mund të lexohet, se si është një përmbledhje ku
6 thuhet që:

7 "Thaçi përsëriti synimin e tij të politizimit të UÇK-së.
8 Ai donte të ndihmonte për krijimin e një Kosove demokratike,
9 shumëpartiake. Rugova nuk kishte dëshirë që ta bënte një gjë
10 të tillë. Ai ishte produkti i ditëve të vjetra të komunizmit.
11 Thaçi e përsëriti kërkesën e tij për një rol drejtues të
12 UÇK-së në kuadrin e Policisë së Kosovës. Ai reagoi në një
13 mënyrë të kujdesshme ndaj propozimit të Sekretarit të
14 Përgjithshëm për ta zgjeruar Këshillin Tranzitor apo kalimtar
15 të Kosovës duke shtuar anëtarë, një anëtar nga partitë që
16 ishin afër LDK-së së Rugovës."

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tani në pjesën tjetër,
18 ku thuhet se:

19 "Z. Kouchner, Përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm,
20 nënvizoi se ishte e rëndësishme që Thaçi të angazhohej për një
21 Kosovë demokratike shumëpartiake. Disa prej veprimeve të
22 UÇK-së nuk ndihmonin, si për shembull ministrat e qeverisë të
23 cilët lëshonin dekrete me vula zyrtare..."

24 Tani kalojmë në paragrafin tjetër:

25 "Thaçi ra dakord, ai donte ta normalizonte jetën që

1 njerëzit të integroheshin në jetën civile, studentët të
2 shkonin nëpër universitete e kështu me radhë. Dhe për këtë
3 duhej të krijoheshin institucionet demokratike. Ai nuk
4 dëshironte të kishte monopol lidhur -- mbi jetën politike dhe
5 sociale. Demokracia e qëndrueshme në Kosovë mund të arrihet
6 vetëm në qoftë se i tërë Ballkani ishte i lirë, demokratik dhe
7 me kufij të hapur. Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm
8 ra dakord, por për të siguruar stabilitetin në Ballkan ishte e
9 rëndësishme që të fitohej në Kosovë fillimisht".

10 Z. Covey, ishe i pranishëm gjatë këtij takimi?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe a të kujtohet nëse -- ku ndodhi kjo?

13 PË. Ndodhi në shtëpinë e z. Thaçi.

14 PY. Në pjesën 1 thuhet që z. Kouchner i tha z. Thaçi që duhej
15 të jepte angazhimin e tij për një Kosovë shumëpartiake,
16 demokratike dhe si përgjigje z. Thaçi ra dakord dhe tha se
17 dëshironte që të krijoheshin institucionet demokratike dhe
18 nënvizoi se nuk donte monopol mbi pushtet. A e keni kuptuar
19 kështu që z. Thaçi ishte angazhuar që Kosova të ishte
20 shumëpartiake dhe demokratike?

21 PË. Në fakt, për të qenë të saktë, do të duhet të themi që ai
22 e deklaroi këtë angazhim. Është e vështirë që në këtë bisedë
23 si të thuash, të kuptohet se si, cilat gjëra thuheshin me
24 zemër.

25 PY. Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen tjetër,
2 në pjesën e tretë.

3 PY. Ku thuhet se:

4 "Thaçi tha që ... ishte gabim që Rugova nuk kishte marrë
5 pjesë në takimin e parë të Këshillit Tranzitor. Kosova nuk i
6 takonte një partie të veçantë, dhe nuk duhet të lejohej që të
7 mbahej peng nga asnjë grup i veçantë. Përfaqësuesi i
8 Sekretarit të përgjithshëm ra dakord. Puna e Këshillit
9 Tranzitor do të vazhdonte, por ishte e rëndësishme që edhe
10 Rugova të merrte pjesë."

11 A të kujtohet nëse ka patur probleme lidhur me përpjekjet
12 për ta bërë që Rugova të merrte pjesë në KTC?

13 PË. Pyetja ka të bëjë në mënyrë të veçantë me pjesëmarrjen e
14 Rugovës?

15 PY. Po.

16 PË. Po. Rugova në atë kohë mungonte, nuk ishte fare në
17 Kosovë, për arsye që ne nuk i kemi kuptuar në atë kohë. Ai i
18 kishte lënë kolegët e tij në një situatë tepër hutuese, ku nuk
19 merreshin dot vendime.

20 PY. Dhe ajo që shkruhet këtu, a përputhet me atë që ka thënë
21 z. Thaçi që Kosova nuk do të duhet të merret peng nga asnjë
22 grup i veçantë?

23 PË. Po. Në atë kohë ishte paksa ironike antipatia që shprehej
24 kundër Rugovës dhe e cila nuk përputhej me procesin
25 demokratik. Dhe kjo ishte një, pra, pjesë për të kuptuar se

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 43

1 kjo armiqësi a kishte të bënte me një individ të veçantë, apo
2 bëhej thjesht për përpjekje për të krijuar mundësinë për të,
3 për partinë, apo për atë parti që do të përfaqësonte. Pra ne e
4 menduam që kjo ishte pjesë e lëvizjeve për të siguruar
5 pushtetin. E gjitha kjo u bë e qartë më vonë kur u shprehën më
6 qartë edhe interesat e tyre.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në pjesën 5.

9 PY. Diskutimi për policinë. Ku thuhet:

10 "Thaçi nënvizoi se ishte e domosdoshme që të krijohej sa
11 më shpejt Shërbimi i Policisë së Kosovës, KPS-ja. Në përputhje
12 me marrëveshjen për demilitarizimin e transformimin e UÇK-së,
13 UÇK-ja do të duhej të favorizohej gjatë krijimit të KPS-së. Do
14 të ishte ide e mirë që një ekspert i UÇK-së të ishte edhe në
15 komisionin përzgjedhës të UNMIK-ut.

16 "Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm tha se e
17 kuptoi pikëpamjen e Thaçit. Nuk ishte çështje teknike apo
18 politike, së cilës i duhej dhënë zgjidhje politike. Duhej të
19 ofrohej diçka luftëtarëve të UÇK-së, pjesërisht si pjesë e
20 forcave policore, pjesërisht jashtë saj. Covey shtoi që nuk
21 kishte nevojë për marrëveshje të veçanta me UÇK-në. Përvoja e
22 departamenteve policore të vendeve të zhvilluara, ka treguar
23 se aplikantët nga forcat e armatosura gjithmonë kanë patur
24 shans shumë të mirë për ta marrë vendin e punës. Por do të
25 ishte gabim që UÇK-ja të përqendrohej tërësisht në

1 pjesëmarrjen në këtë forcë policore".

2 Të kujtohet ky diskutim gjatë këtij takimi?

3 PË. Po. Dhe është përfaqësim i përvojës sime në Bosnjë ku kam
4 marrë pjesë në veprime për krijimin e një force policie të
5 bazuar në komunitetet ekzistuese, forcë policore e cila do të
6 zëvendësonte ish-policinë jugosllave. Ndryshimi ishte se
7 forcat e ish-Jugosllavisë kishin për mandat të mbronin
8 shtetin, ndërkohë që policia komunitare që synonim ne ishte
9 një polici që do të mbronte publikun. Dhe ky ishte ndryshim
10 themelor dhe kjo përpjekje jona doli se ishte shumë e
11 suksesshme në Bosnjë, dhe kjo nënkuptoi që individët kanë bërë
12 kërkesë dhe janë kontrolluar, si të thuash, nga pikëpamja
13 individuale përpara se të punësoheshin. Nuk ishte ky një
14 transferim si njësi e tërë.

15 Dhe të gjitha shkëmbimet që kemi bërë me kosovarët kishin
16 të bënin pikërisht me faktin që një ushtar i UÇK-së mund të
17 ishte, të kishte të gjitha kualifikimet, për t'u bërë një
18 kadet i policisë, dhe mund të siguronte kështu jetesën dhe të
19 shndërrohej në një qenie njerëzore me respekt nga pikëpamja e
20 shoqërisë, dhe këtë e diskutuam më vonë, ajo që quhej edhe
21 procesi i DDR-së, ose procesi i çarmatosjes, i largimit nga
22 forcat dhe integritet të forcave të armatosura të pjesëtarëve
23 të ish-forcave të armatosura.

24 PY. Dhe si pjesë e këtij procesi, dhe këtu thuhet se z.

25 Kouchner thotë që "UÇK-së do t'i duhet t'i ofrohet diçka që të

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 45

1 jetë ose pjesë e policisë ose jashtë". A ishte kjo e
2 rëndësishme si pjesë e DDR-së?

3 PË. Kjo është nën shkronjën R që ka të bëjë me riintegrimin.

4 PY. Faleminderit.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë tek pjesa e
6 përfundimeve.

7 PY. Këtu thuhet:

8 "Në diskutimet e tij të paraintensive me përfaqësuesin e
9 Sekretarit të Përgjithshëm, Thaçi u përpoq që ta përfaqësonte
10 veten si një demokrat shumëpartiak. Ai mbase e kishte për
11 njëmend këtë gjë, por akoma ishte e paqartë në goftë se do të
12 mund ta linte UÇK-në pas. Për ta mbajtur UÇK-në në rrugën e
13 demokratizimit, ishte e rëndësishme që të menaxhohej një
14 riintegrim i të gjithë ish-luftëtarëve në jetën civile. Për
15 këtë na duhej që të bindnim Thaçin (dhe ajo çfarë është më e
16 rëndësishme ishte e rëndësishme për neve që të bindnim
17 elementët radikalë të UÇK-së) dhe duhej që të bindnim të
18 gjithë këta që bëhej fjalë për poste të rëndësishme në jetën
19 civile dhe jo vetëm në shërbimin policor".

20 A pajtohem me atë çfarë është shkruar këtu, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, ishte e rëndësishme që të integroheshin
23 ish-luftëtarët e UÇK-së në forcën policore. Pajtoheni me këtë?

24 PË. Po.

25 PY. Po ashtu, a pajtoheni me atë çfarë citohet në këtë pjesë

1 të përfundimit të këtij dokumenti që nuk ishte bindëse në
2 qoftë se z. Thaçi do të mundej që t'i integronte
3 ish-luftëtarët e UÇK-së?

4 PË. Po.

5 PY. A pajtoheni me këtë pjesën tjetër të përfundimeve ku
6 thuhet që çfarë ishte edhe më e rëndësishme ishte që të
7 bindeshin elementët radikalë në UÇK?

8 PË. Po.

9 PY. A e dini ju se kush ishin këta elementë radikalë, ose
10 "elementët më radikalë" siç thuhet në tekst?

11 PË. Unë nuk kam pasur asnjëherë një pasqyrë të plotë apo një
12 kuptim shumë të mirë, një skemë të mirë, të asaj çfarë ushtria
13 do ta quante rendi i luftimeve të UÇK-së, për të kuptuar më
14 qartë se kush ishte përgjegjës për një rajon të caktuar, një
15 zonë të caktuar dhe kujt i raportonte ky person i caktuar. Një
16 pjesë e mirëkuptimit tonë kishte të bënte me faktin që jeta e
17 brendshme e UÇK-së sipas KFOR-it. Dhe në fakt unë edhe vetë
18 personalisht kam pasur kontakte të rregullta me UÇK-në në të
19 gjithë nivelet, dhe sigurisht që kishte persona të caktuar me
20 të cilët UÇK-ja dëshironte që të fliste, në kuptimin e
21 preferencës për të folur. Nuk e di në qoftë se duhet të jap
22 një shpjegim tjetër se këtu nuk e kam fjalën për biseda
23 rastësore.

24 Por, më duhet të them që prej ditës së parë kur kemi qenë
25 në Kosovë, e kam fjalën për Kouchner dhe për veten time, kemi

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 47

1 organizuar takime të vazhdueshme, të rregullta, me Mike
2 Jackson në selinë e vet. Dhe qëllimi kryesor ka qenë që të
3 shkëmbejmë informacion, domethënë, thjesht të flasim me njëri-
4 tjetrin dhe të marrim vesh çfarë po ndodhte. Ne nuk është se
5 kishim ndonjë agjendë të veçantë. Gjenerali Mike na jepte
6 neve, ose kalonte pikat njëra pas tjetrës lidhur me atë çfarë
7 kishte mësuar dhe çfarë synonte të bënte dhe të njëjtën gjë e
8 bënte edhe Kouchner. Por, përgjithësisht Kouchner thoshte se
9 çfarë i nevojitej si mbështetje nga KFOR-i.

10 Nuk është se organizoheshin takime për të thënë që kjo
11 është UÇK-ja, këto janë organizimet dhe pikat me të cilat ata
12 po merren, por thjesht kishim të bënim me një shkëmbim të
13 përgjithshëm informacioni. Dhe, edhe sot unë nuk mund t'ju jap
14 me saktësi, vetëm thjesht mund të përpiqem t'ju jap një listë
15 të personaliteteve të UÇK-së. Megjithatë, nuk mund të them
16 shumë gjë me saktësi lidhur me këtë.

17 PY. Në rregull.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar do ju kërkoja të
19 paraqisni në ekran dokumentin DHT05440 deri në DHT05442.

20 PY. Ky është një kabllogram që është dërguar nga z. Kouchner,
21 data është 26 korrik 1999, dhe ka të bëjë me takime me LDK-në.
22 Në qoftë se lexoni aty tema është "Takime me LDK-në".

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen tjetër të
24 këtij dokumenti.

25 PY. Në përmbledhje thuhet që:

1 "LDK-ja dhe palët në parlamentin e mbyllur të LDK-së,
2 partitë në parlamentin e mbyllur të LDK-së, insistojnë që ata
3 duhet të kenë më tepër vende në këshillin tranzitor të
4 Kosovës".

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim më poshtë tekstin. Edhe
6 pak më poshtë, në fund të faqes thuhet:

7 "Atëherë, së pari duhet t'ju them që bëhet fjalë për një
8 takim të organizuar më datë 26 korrik. Domethënë, diskutohet
9 përmbajtja, pra është një takim i Përfaqësuesit të Sekretarit
10 të Përgjithshëm me 15 persona nga presidenca e LDK-së. Dhe më
11 pas thuhet që:

12 "U organizua një darkë me z. Alush Agushi, anëtar i
13 presidencës. Më datë 25 korrik u takua me z. Ajeti, me z.
14 Kurteshi, dhe z. Gjergj Dedaj, drejtues ose kryetar i Partisë
15 Liberale. Takimet u përqendruan mbi rolin e LDK-së dhe
16 përbërjen e KTC-së, Këshillit të Përkohshëm të Kosovës."

17 Në fund të faqes thuhet:

18 "Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm tha që do
19 përpiqej që të ndryshojë përbërjen e Këshillit, por ishte e
20 rëndësishme për LDK-në të kuptonte se realitetet politike të
21 Kosovës kishin ndryshuar gjatë 15 muajve të fundit. LDK-ja nuk
22 ishte më partia e vetme e madhe politike. Ata gjithashtu
23 kishin nënshkruar marrëveshjen e Rambujesë si të barabartë me
24 tre faktorë të tjerë, UÇK, LDB dhe të pavarurit. Kjo po e
25 bënte të vështirë që të vendoseshin", vazhdojmë me faqen

1 tjetër, pra "po e bënte të vështirë që përbërja e KTC-së të
2 kthehej përmbys. Megjithatë, ai ishte i vendosur t'i jepte
3 LDK-së dhe partive rreth saj një tjetër vend të tretë".

4 A pajtoheni me mua, Dëshmitar, që diskutimet, apo bisedat
5 në Rambuje midis UÇK-së, LDK-së dhe LBD-së ishin që të
6 krijohej një qeveri e përkohshme e Kosovës? UNMIK-u, a e ka
7 përmendur një marrëveshje të tillë, Marrëveshjen e Rambujesë
8 si bazë për t'i dhënë vende partive ose palëve në Rambuje në
9 Këshillin e Përkohshëm të Kosovës?

10 PË. Duhet ta themi me kujdes që Rezoluta e Këshillit të
11 Sigurimit 1244 mori ose zëvendësoi çdo gjë që u pajtuan palët,
12 për të cilën u pajtuan palët në Rambuje, sa i takon statusit.
13 Dhe Kombet e Bashkuara vendosën që UNMIK-u do ishte
14 administratori i vendit. Megjithatë, Sergio De Mello kishte
15 përcaktuar një lloj baze mbështetur në të cilën që të
16 mbledheshin së bashku një grup përfaqësuesish, njerëzish që të
17 punonin dhe shpresohej që ata të mund të ofronin përfaqësim në
18 të gjithë peizazhin politik të Kosovës. Nuk ishte befasi që ai
19 u mbështet në bazën ose diskutimet e Rambujesë dhe megjithatë
20 është e rëndësishme që ne nuk është se e kemi parë atë si
21 skicë ose si shabllon që duhet të që ndiqet më pas. Ishte një
22 pikë e mirë nisëse, ishte një pikë nga ku ia vlejje që të
23 niseshe, megjithatë ne nuk është se jemi ndier të detyruar
24 prej saj. Por, megjithatë, në përgjigje të pyetjes mund të
25 them që po, ishte një draft fillestar i dobishëm për ne.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë tek prova gjyqësore
2 P00743.2.

3 PY. Z. Covey, bëhet fjalë për një raport të OSBE-së që mban
4 titullin "Siç është parë, ashtu është raportuar". Është një
5 raport që ka të bëjë me situatën e të drejtave të njeriut në
6 Kosovë, në periudhën pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, dhe pas
7 hyrjes së UNMIK-ut. Atëherë, shikoni parathënien sikurse mund
8 ta lexoni dhe vetë, parathënia është shkruar nga Përfaqësuesi
9 i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të
10 Bashkuara, z. Bernard Kouchner.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të
12 kalojë te një pjesë e këtij, e kësaj pjese, ose e kësaj
13 hyrjeje që është shkruar nga z. Kouchner. Raporti është botuar
14 në nëntor të vitit 1999. Për këtë do i kërkoja Sekretarit të
15 paraqesë në ekran faqen SITF000001534, që është faqja 2 e
16 dokumentit. Nuk është kjo faqja e duhur. Kjo është faqja.
17 Atëherë është paragrafi ku fillon që "Jemi shumë të
18 shqetësuar..."

19 PY. Këtu thuhet:

20 "Jemi thellësisht të shqetësuar lidhur me situatën e
21 pakicave. Një vështrim nga afër i tendencës së krimeve tregon
22 një përmirësim të qartë. Ka një ulje nga 50 vrasje gjatë
23 javëve të para, në tre vrasje javën e fundit. Kjo është një e
24 dhënë e cila nuk mund të injorohet. Megjithatë, kjo nuk do të
25 thotë që një krim nuk është domethënës. Megjithatë, gjërat po

1 ndryshojnë. Nuk është e drejtë që të bëhen krahasime me
2 situatën përpara ose gjatë luftës. Në atë kohë, dhe për të
3 paktën një dekadë, ka pasur një politikë sistematike
4 aparteidi, një status jonjerëzor ose të paktën një status
5 nënkomuniteti për shqiptarët në Kosovë. Ky nuk është më
6 realiteti i sotëm. Mbase mund të duket situata po aq e keqe
7 sot për serbët ose romët të cilët jetojnë në frikë dhe që nuk
8 mund të lëvizin lirshëm ose që duhet të gjejnë një mënyrë për
9 të mbrojtur fëmijët e tyre. Por, kjo nuk është më çështje
10 politike të përgjithshme. Të gjitha palët në Kosovë, të gjithë
11 udhëheqësit, serbë dhe shqiptarë, kanë deklaruar qëndrimet e
12 tyre pro një shoqërie multietnike dhe bashkëjetesë midis të
13 gjithë komuniteteve. Krimet që shohim ne janë akte të
14 individëve të caktuar. Asnjë parti politike nuk ka marrë
15 përsipër përgjegjësinë lidhur me to. Përfaqësuesit e tyre në
16 Këshillin Tranzitor të Kosovës kanë dënuar këto abuzime çdo
17 herë kur ato kanë ndodhur dhe ata vetë kanë shprehur
18 shqetësimet e tyre lidhur me këto akte intolerance. Ne nuk
19 mund të përjashtojmë mundësinë e bisedave të dyfishta, por as
20 nuk e presupozojmë atë dot".

21 Pyetja e parë që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: Kjo
22 çfarë ka shkruar z. Kouchner lidhur me situatën në Kosovë, në
23 vitin 1999, në verë të 1999, a përkon me atë çfarë ju kujtohet
24 ju?

25 PË. Po.

1 PY. Presupozimi ose parashtrimi që jepet këtu që krimet që po
2 ndodhnin në atë kohë nuk ishin më çështje politikash të
3 përgjithshme, por ishin raste individuale, a është kjo në
4 përputhje me atë çfarë ka thënë z. Kouchner dhe a është kjo
5 politika e përgjithshme e UNMIK-ut në atë kohë?

6 PË. Pa diskutim, sa i takon UNMIK-ut, por rrjedhimisht kishte
7 konsensus të figurave të tjera lidhur me JIAS-në, dhe JIAS-ja
8 këtu është Administrata e Përkohshme, Struktura e
9 Administratës së Përkohshme.

10 PY. Dhe gjithashtu këtu thuhet që:

11 "... të gjitha palët kanë rënë dakord dhe dënojnë çdo akt
12 të tillë, dhe të gjithë udhëheqësit serbë dhe shqiptarë kanë
13 deklaruar pozicionet e tyre pro shoqërisë multietnike dhe
14 bashkëjetesë së komuniteteve."

15 A e dini në qoftë se z. Thaçi është njëri prej këtyre
16 udhëheqësve.

17 PË. Po, përfshihet edhe ai këtu.

18 PY. Thuhet më tej në tekst që:

19 "Përfaqësuesit në Këshillët Tranzitorë të Kosovës kanë
20 dënuar abuzimet çdo herë dhe kanë shprehur gjithashtu dhe
21 shqetësimet e tyre lidhur me aktet e intolerancës."

22 A e dini në qoftë se z. Thaçi është njëri prej këtyre
23 personave që e ka dënuar akte të tilla, Dëshmitar?

24 PË. Atëherë, mendoj që është e rëndësishme që të bëhet një
25 sqarim këtu. Në takimin e parë të Këshillit Tranzitor të

1 Kosovës, që do ketë ndodhur, besoj, diçka nga mesi i korrikut
2 në datë 16, domethënë, pasi ne mbërritëm në Kosovë, ka pasur
3 qëndrime të tilla të shprehura. Ndërkohë që takimi i dytë
4 është organizuar pas vrasjeve në Graçko. Ju kërkoj ndjesë se
5 nuk më kujtohet mirë data, dhe prandaj po hezitoj pak, por kam
6 përshtypjen që do ketë qenë pak më pas. Nuk e di në qoftë se
7 mund të më kujtoni se kur ka ndodhur masakra, kur ka ndodhur
8 vrasja?

9 PY. Në qoftë se nuk ka kundërshtim Prokuroria, mund t'jua
10 them. Besoj që ka qenë diku nga 22 korriku.

11 PË. Po. I takon që ka qenë menjëherë pas takimit të parë të
12 Këshillit Tranzitor të Kosovës. Dhe në atë takim Kouchner
13 shpresonte që të merrte një deklaratë nga Këshilli Tranzitor i
14 Kosovës, si grup, si një i tërë, që dënonte vrasjet dhe që
15 shprehte nevojën për mosekzistencën e dhunës ose mosushtimin
16 e dhunës. Dhe mbaj mend që ishte e pamundur që të sigurohej
17 një deklaratë e tillë. Asnjë nga personat që ishin të
18 pranishëm në këtë takim të dytë të Këshillit Tranzitor të
19 Kosovës nuk donte të nënshkruante një deklaratë të tillë. Në
20 këtë pikë, një përfaqësues serb, po ashtu Trajkovic dhe
21 persona të tjerë, dhe të tjerët u larguan dhe filluan që të
22 mos e shikonin Këshillin Tranzitor të Kosovës si një organ
23 funksional për atë periudhë.

24 Unë e di që personat që nuk morën pjesë në një deklaratë
25 të tillë ose nuk u pajtuan me idenë për të dhënë një deklaratë

1 të tillë ishte, ndër të tjerë, edhe Veton Surroi që ishte një
2 avokat i të drejtave të njeriut, por përfshinte dhe z. Thaçi.
3 Ne mbetëm të befasuar dhe kjo zgjati për ca kohë, në veçanti
4 kur mësuam me kalimin e kohës që ai kishte bërë deklaratë të
5 mëparshme dhe të menjëhershme sa i takon Këshillit Tranzitor
6 të Kosovës kur shpreheshin ndjesitë dhe më duhet të them që
7 dukej sikur Këshilli Tranzitor i Kosovës nuk ishte gjithë
8 kohës në një linjë.

9 Megjithatë, në përjashtim të këtij rasti, me sa di unë,
10 në të gjitha rastet e tjera z. Thaçi është shprehur
11 ekzaktësisht në këtë mënyrë, domethënë ka dënuar sulmet dhe ka
12 dhënë përshtypjet e veta sa i takon punës që duhet të bënte
13 këshilli tranzitor i Kosovës.

14 PY. Faleminderit. Tani kam një pyetje tjetër që ka të bëjë me
15 takimin e Këshillit Tranzitor pas vrasjeve në Graçko. A ju
16 kujtohet në qoftë se përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës u
17 pajtuan që të bënin një deklaratë të tillë, kishte ndonjë
18 person që u pajtua me një deklaratë të tillë?

19 PË. Jo, askush nga ata, asnjë nga personat që ka qenë i
20 pranishëm në takim nuk donte që të jepte një deklaratë.

21 Megjithatë, z. Thaçi dhe një deklaratë pak, shumë pak kohë në
22 emrin e vet personal lidhur me situatën.

23 PY. Në rregull. Do kemi mundësi që të flasim pak më tepër sa
24 i takon deklaratave. Megjithatë, përpara se sa të vazhdojmë me
25 pushimin, do të kërkoja që të shikonim një tjetër dokument që

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 55

1 është, që ka të bëjë me një tjetër temë bisede.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Më konkretisht është dokumenti
3 DHT04827 deri në DHT04838.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Patjetër.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Bëhet fjalë për një buletin
6 *online*, që është Raport i Krizës në Ballkan. Kështu që besoj
7 që mund ta lexoni dhe vetë dokumentin. Është një dokument që
8 mban datën 20 shtator 1999. Të shkojmë në fund të faqes, te
9 paragrafi që fillon me "Ndërsa...".

10 PY. Pra, dhe një herë bëhet fjalë për shtator. Këtu në këtë
11 pjesë të artikullit thuhet:

12 "Ndërkohë liderschafti i UÇK-së është shpërndarë në disa
13 parti. Partia që të bie më shumë në sy është partia -- PBD-ja
14 që drejtohet nga Bardhyl Mahmuti, që është përfaqësues politik
15 i UÇK-së, i ish-UÇK-së për Evropën Perëndimore, që ia ka dalë
16 që të tërheqë mbështetjen e shumë përfaqësuesve dhe
17 komandantëve të respektuar në terren të UÇK-së.

18 "Hashim Thaçi, kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të
19 Kosovës, e cila nuk njihet nga UNMIK-u, gjithashtu ka njoftuar
20 se edhe ai do të formojë partinë e tij politike pa dhënë
21 hollësi të mëtejshme. Javën e shkuar Thaçi vizitoi fshatin e
22 Prekazit ku u takua me Rifat Jasharin, që është i vetmi vëlla
23 i mbijetuar i familjes së Adem Jasharit, sakrifica e të cilit
24 njihet nga të gjithë kosovarët".

25 Kalojmë tek faqja tjetër:

1 "Mbështetja nga familja e Jasharëve do ishte një avantazh
2 shumë i madh në zgjedhje. Thaçi u takua gjithashtu edhe me
3 komandantin e zonës së Drenicës së UÇK-së në përpjekje për të
4 konfirmuar mbështetjen vendore për partinë e tij. Por, kishte
5 gjithashtu ndasi dhe ndarje midis Thaçit dhe Mahmutit i cili
6 ka mbështetës të tij brenda segmentit të UÇK-së. Megjithatë,
7 këta janë lojtarë politikë të rinj dhe nuk është e qartë se
8 çfarë agjende do të kenë ata".

9 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: A keni qenë
10 ju të informuar që në atë kohë UÇK-ja vetë ishte shpërbërë në
11 disa fraksione ose në disa nënndarje politike të ndryshme?
12 PË. Kishim informacione që nuk kishte konsensus të qartë dhe
13 të plotë ndërmjet individëve të lartë të UÇK-së. Do e lë me
14 kaq, do them që e dimë që kishte një lloj përçarje, por nga
15 ana tjetër nuk e dinim deri në çfarë mase ishin këto përçarje
16 dhe nuk kishim informacione kaq shumë të hollësishme sa jepen
17 në këtë artikull, në kuptimin që kush është në mbështetje të
18 kujt. Zakonisht gazetarët kanë tendencë që të lexojnë më tepër
19 situata të caktuara dhe të shkojnë në hollësi që nuk
20 mbështetet nga historia. Unë personalisht nuk do i kisha marrë
21 kaq shumë seriozisht këto hollësi që jepen në këtë raport,
22 megjithatë ne ishim të informuar për faktin që nuk kishte
23 konsensus ndërmjet udhëheqësve të lartë të UÇK-së.

24 PY. Por këtu në raport thuhet që z. Thaçi ka shkuar dhe ka
25 folur me, ka shkuar për t'u takuar me komandantin e zonës së

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 57

1 Drenicës, së UÇK-së, në përpjekje për të fituar mbështetjen e
2 tij, ose mbështetjen për partinë e tij. A kishte një lloj të
3 tillë marrëdhënie midis z. Thaçi dhe anëtarëve të tjerë të
4 UÇK-së?

5 PË. Jo tamam kështu. Mund të pritej që një politikan të
6 takohet me zgjedhësit, megjithatë, në qoftë se unë do kisha
7 lexuar një informacion të tillë në atë kohë, me thënë të
8 drejtën do isha befasuar sepse nuk më dukej një gjë e
9 natyrshme që të lloboja për komandantë e me komandantë
10 individualë, në veçanti me komandantin e zonës që thatë sepse
11 ky ishte një person goxha strikt dhe i ashpër.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do kërkoj që ky
14 dokument të pranohet në prova gjyqësore.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm faqet
16 që pamë apo i gjithë dokumenti?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, i gjithë dokumenti.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
19 DHT04837 deri në 04838 pranohet në prova.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt numri i dokumentit është
21 DHT04837 deri në 048438 [Sipas përkthimit].

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po këtë
23 thashë dhe unë.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Më duket se e thatë pak gabim. E
25 thashë unë gabim, është faji im. Është dokumenti 427 deri në

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 58

1 4838.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
3 pranohet.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
5 dokumenti DHT04827 deri në DHT04838 do pranohet dhe do marrë
6 numrin e provës 1D00404, dhe klasifikimi aktualisht është
7 publik.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Përkthim] Dëshmitar, tani do bëjmë pushim për 30 minuta.
10 Atëherë, do takohemi përsëri në sallën e gjyqit në orën 11.35.
11 Atëherë, ju lutem, nuk duhet të flisni me askënd lidhur me
12 dëshminë përpara Trupit Gjykues.

13 Mund të largoheni nga salla. Por do shihemi këtu për 30
14 minuta pas pushimit.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
18 pushimin deri në 11.35.

19 --- Pauza fillon në orën 11.04

20 --- Seanca rifillon në orën 11.35

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Z. Misetic, kishit
22 materiale për të paraqitur për pranim si prova?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Duhet ta kisha bërë
24 më parë. Është faji im. Harrova të dorëzoj, të paraqes një
25 dokument që i tregova dëshmitarit. Kërkoj ndjesë Gjykatës për

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 59

1 këtë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] DHT05440 deri në DHT05442 që është
4 kabllogrami i UNMIK-ut që ka të bëjë me bisedën që z. Kouchner
5 pati me përfaqësues të LDK-së.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni të
7 drejtë, nuk është paraqitur si provë.

8 Ka ndonjë kundërshtim për këtë?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT05440 deri
11 në 05442 pranohet.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
13 provës materiale 1D00405, është i klasifikuar si konfidencial.
14 Faleminderit.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publik.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
17 riklasifikohet si publik.

18 Znj. Asistente, sillni dëshmitarin në sallë.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Z. Covey, vazhdojmë me pyetjet që do t'ju parashtrojë z.
22 Misetic.

23 Vazhdoni.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

25 PY. Mirë se erdhët, Z. Covey.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 60

1 PË. Faleminderit.

2 PY. A ishit në dijeni në verë dhe vjeshtë të 1999-s, ndoshta
3 dhe në dimër, deri në dimër 1999, 2000, nëse z. Rugova
4 paraqiste dhe e shihte veten si President i Kosovës?

5 PË. Jo në kuptimplotë apo në mënyrë të njëmend. Nuk më
6 kujtohet saktësisht kjo, jo.

7 PY. Në rregull. Kalojmë në diçka tjetër.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kërkoj të shfaqim në ekran
9 dokumentin DHT00883 deri në 00883.

10 PY. Z. Covey, e njihni këtë imazh, fotografi?

11 PË. Duket të jetë takimi i parë i KTK-së.

12 PY. Jeni në gjendje të identifikoni personat në këtë
13 fotografi?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që t'i
15 japë mundësinë dëshmitarit të shënojë me numër personat që
16 identifikon.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. Mendoj që ky është
18 Sergio de Mello. Ky është, natyrisht, Kouchner.

19 PY. Pra, 1 është De Mello, 2 Kouchner.

20 PY. 3 Gjenerali Mike.

21 PY. Gjenerali Jackson.

22 PY. Artemije, Bishop Artemije 4. 5 mendoj që është z.

23 Trajkovic. Ky është z. Thaçi 6. Dhe ky jam unë.

24 PY. Për procesverbalin, pra, 0 jeni vetë, 3 Gjenerali
25 Jackson, 4 Artemije, 5 Trajkovic, 6 z. Thaçi.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 61

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, do të kërkoja të bëhet
2 një fotografi e kësaj fotografie të shënuar me numra dhe të
3 pranohet si provë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
5 kundërshtim?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fotografia e
8 shënuar pranohet.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Fotografia me shënimet
10 do të marrë numrin e provës materiale 1D00406. Ishte e
11 klasifikuar si publike.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull është. Faleminderit.

13 PY. Z. Covey, tani do të kalojmë tek tema e Strukturës
14 Administrative të Përkohshme të Përbashkët.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe do të kërkoj që të kalojmë në
16 faqen DHT05457 deri në 05478. Në faqen DHT05458, z. Sekretar.

17 PY. Z. Covey, këtu në ekran shikoni që është kabllogrami që
18 është dërguar nga z. Kouchner Kofi Annan, datë 16 nëntor 1999.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe në qoftë se shohim pikën e
20 parë në këtë faqe. Më lejoni të filloj.

21 PY. Fillimisht me paragrafin e parë:

22 "Siç jam ngarkuar nga Sekretari i Përgjithshëm, kam
23 zhvilluar bisedime me udhëheqësit politikë kryesorë shqiptarë
24 të Kosovës, Thaçi, Rugova dhe Qosja, midis datës 12 dhe 15
25 nëntor, në lidhje me pikën e përfshirjes së popullit të

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 62

1 Kosovës, njerëzve të Kosovës në mënyrë më të drejtpërdrejtë në
2 administratën e UNMIK-ut, duke e bërë administrimin tonë më
3 efikas dhe më të pranueshëm për popullsinë.

4 "Në këto bisedime, të gjithë udhëheqësit pranuan rolin
5 tim special të posaçëm si PSSP, pra, si autoritet legjislativ
6 dhe vendimmarrësi përfundimtar. Ishte e qartë, për rrjedhojë,
7 që unë nuk do të merrja pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në
8 ndonjë strukturë administrative të përbashkët."

9 A përputhet kjo me atë që ju kujtohet juve në atë kohë sa
10 i takon qasjes së udhëheqjes shqiptarë, përfshirë z. Thaçi në
11 lidhje me PSSP-në dhe pushtetin e tij, autoritetin e tij?

12 PË. Po.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, do të paraqes këtë
15 kabllogram si provë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
17 kundërshtim?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT05457 deri
20 në 05458 pranohet dhe do t'i jepet një numër prove materiale.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Ky do të
22 marrë numrin e provës materiale 1D00407 dhe klasifikimi është
23 konfidencial.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
25 mbetet konfidencial?

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 63

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, mund të jetë publik.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Atëherë mund të riklasifikohet si publik.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Një çast, ju lutem.

5 Z. Sekretar, në qoftë se mund të shfaqni në ekran

6 DHT05754 deri në DHT05760.

7 PY. Z. Covey, kjo është një kabllogram tjetër i dërguar nga

8 z. Kouchner Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të

9 Bashkuara.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim pak më poshtë.

11 PY. Pika 2 lexon:

12 "Pas miratimit marrëveshja u nënshkrua sot në mëngjes nga
13 tre udhëheqësit e partive politike shqiptare të Kosovës Thaçi
14 (PPDK), Rugova (LDK), Qosja (LBD) dhe unë isha i pranishëm dhe
15 e pranova atë."

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

17 PY. E njihni këtë dokument?

18 PË. Po.

19 PY. Çfarë është?

20 PË. Kjo është marrëveshja për t'u bashkuar së bashku në
21 strukturë administrative të përbashkët.

22 PY. Faleminderit.

23 PË. Kërkoj ndjesë, dua të them që kjo më zgjon emocione sepse
24 ka qenë një zhvillim tejet i rëndësishëm masiv.

25 PY. Pse?

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 64

1 PË. Më duket, bëhem pak si nxënës shkolle, po. Po keni
2 parasysh se paqëbërja, paqruajtja është që të përmbysësh
3 parimet e Clausewitz. Clausewitz thotë që: "Lufta është
4 politika përmes mjeteve të tjera". Për neve paqëbërja është
5 politika e paqëbërjes, lufta me mënyra tjera sepse fillimisht
6 kur konflikti përfundon formalisht, zyrtarisht asgjë nuk është
7 zgjidhur. Cilado qoftë arsyeja që i çoi palët në konflikt, ato
8 interesa mbeten të paarritura në përgjithësi dhe e vetmja
9 mënyrë për të ecur përpara është që palët në konflikt të bëjnë
10 të arrihet që ato të bëjnë një rivlerësim të atyre që kanë
11 menduar se ishin interesat e tyre. Dhe kemi, pra, dëshmi që
12 kjo është ajo që ka ndodhur.

13 PY. Faleminderit, Z. Covey.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, një dokument i
15 ngjashëm me këtë është pranuar si 1D400, por ky është versioni
16 me më pak redakte dhe do të donim që të paraqisnim këtë
17 dokument, pra, me më pak redakte.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
19 kundërshtim?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo. Nuk ka kundërshtime, në qoftë
21 se mund të jetë pika 1 e kësaj prove materiale në mënyrë që të
22 jetë e qartë?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull me neve.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ia
25 bashkojmë këtë provës tjetër materiale.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 65

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Pra, është 1D400.1,
2 besoj.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e
4 konfirmojmë se DHT05754 deri në DHT05760 do të marrë numrin e
5 provës materiale 1D00400.1 dhe është i klasifikuar si
6 konfidencial.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publike.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mund të jetë publike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Do të riklasifikohet si publik.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, faleminderit. Në rregull.

12 Tani, z. Sekretar, do të doja që të shfaqni në ekran
13 videon që është DHT00930 deri në DHT00930. Të shohim videon.

14 [Luhet videoincizimi]

15 "Rambujsja kthehet prapë. Duhet të nënshkruajmë dhe jemi
16 këtu si dëshmitarë. Është historike.

17 "Urime.

18 "Ju lumtë."

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Mund të ndalojmë
20 videon.

21 PY. Z. Covey, e njohët se për çfarë bëhet fjalë në këtë
22 ngjarje?

23 PË. Ishte nënshkrimi i SPAP-së.

24 PY. Dhe ju ishit i pranishëm?

25 PË. Po.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetiç

Faqe 66

1 PY. Videoja a pasqyron me saktësi nënshkrimin siç ju kujtohet
2 juve?

3 PË. Po, përveç, duke përjashtuar lotët.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, paraqes videon për t'u
5 pranuar në prova si DHT00930 deri DHT00930.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
7 kundërshtim?

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, duhet të shtoj
10 diçka. Transkripti është pranuar nga Trupi Gjykses si provë
11 materiale 1D00396, do të kërkojmë që thjesht videoja t'i
12 shtohet kësaj prove materiale me .1.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
14 kështu. Faleminderit.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë do të kemi -- a
16 mund të na përsërisni numrin e provës materiale, ju lutem?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] 1D00396 dhe mund të jetë publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të
19 jetë 396.1

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Sekretar, ju lutem shfaqni në ekran dokumentin
22 DHT05449 deri në DHT05450.

23 PY. Z. Covey, ky është një kabllogram që i është dërguar nga
24 z. Kouchner Kombeve të Bashkuara në New York, mban datën 18
25 dhjetor 1999 dhe titulli është "Reagime ndaj marrëveshjes së

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 67

1 15 dhjetorit mbi Strukturën Administrative të Përbashkët". Dhe
2 tani kalojmë në faqen e parë të këtij dokumenti, paragrafi i
3 tretë nga krye, thuhet:

4 "Partia radikale LKÇK (Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e
5 Kosovës) më 14 dhjetor u largua nga e ashtuquajtura 'Qeveri e
6 Përkohshme e Kosovës' e z. Thaçi kur u bë e qartë se z. Thaçi
7 pranoi marrëveshjen dhe për rrjedhojë zhbërjen e 'KIG-së'.
8 Shumë zyrtarë të 'KIG-së' ishin të pakënaqur me marrëveshjen
9 pasi ata humbnin pozitat e tyre, titujt dhe statusin që
10 buronte nga kjo."

11 Pyetja ime e parë ka të bëjë me nëse ky përshkrim
12 përputhet me atë që ju kujtohet juve lidhur me gatishmërinë e
13 Thaçit për të zhbërë Qeverinë e Përkohshme të Kosovës siç i
14 referohet këtu pra?

15 PË. Në përgjithësi përputhet.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Paraqes këtë kabllogram si provë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
19 kundërshtim?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT05449 deri
22 në 05450 pranohet.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës
24 materiale 1D00408 dhe është i klasifikuar si konfidencial.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publik.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 68

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

2 Riklasifikojeni si publike.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Sekretar, shfaqni në ekran DHT05680 deri në DHT05686.

5 PY. Këtu është një kabllogram tjetër që i është dërguar nga

6 z. Kouchner Kombeve të Bashkuara në New York, mban datën 8

7 shkurt 2000, tema është takimi me z. Donelly.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

9 PY. Z. Donnelly, pra, nga Ministria e Punëve të Jashtme të
10 Mbretërisë së Bashkuar.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

12 PY. Dhe shohim aty që ky takim ju ishit,, përfshinë personat
13 e pranishëm përfshirë edhe juve, Z. Covey. E shihni këtë?

14 PË. Po.

15 PY. Ju kujtohet që të keni qenë i pranishëm në takim me z.

16 Brian Donnelly në zyrat e UNMIK-ut në janar 2000?

17 PË. Po, megjithëse nuk më kujtohet shumë mirë.

18 PY. Nëse mund të kalojmë tani në këtë faqe por pak më poshtë

19 paragrafi i dytë, pra:

20 "Zëvendësi i parë i PSSP-së", që identifikohet si ju,

21 "deklaron se, në një farë mënyre, ishte akoma 1989 në Kosovë,

22 ku shtetet e tjera komuniste kishin filluar tashmë rrugën e

23 reformave dhe Ballkani kishte hapur luftë pjesërisht. Sepse

24 popullsia e Kosovës nuk kishte përjetuar procesin e reformave,

25 shumë prej tyre kishin një mosbesim të thellë të

1 institucioneve zyrtare dhe një prirje të natyrshme për të
2 ndërtuar struktura paralele."

3 Kjo që është shkruar këtu a pasqyron qëndrimin tuaj
4 lidhur me Kosovën në vitin 2000?

5 PË. Po. Dhe do të shtoja si poshtëshënim që në një mënyrë kjo
6 vjen dhe nga përvoja që kam patur në Berlin dhe ribashkimi i
7 Gjermanisë, ku Gjermania Perëndimore kishte përfituar nga 30
8 vite apo më shumë reforma shumë energjike, veçanërisht që nga
9 viti 1968, ndërkohë qemë shumë Gjermani Lindore jo. Ata ishin
10 mësuar, ishin indoktrinuvar se të gjitha të këqijat dhe mëkatet
11 e Rajhut të Tretë ishin trashëguar nga perëndimi dhe se
12 Hitleri kishte personifikuar komunistët, pra, që Perëndimi që
13 kishte përjetuar -- ajo që kishte ndodhur në perëndim nuk
14 kishte ndodhur në Gjermaninë Lindore dhe nuk është e habitshme
15 që fuqia e ekstremit të djathtë, *skinheads*, pra, çështjet e
16 dhunës kundër minoriteteve në Gjermaninë Lindore, në pjesën
17 lindore të Berlinit, vazhduan dhe ishin të pranishme.

18 Nuk dua që të largohem, të devijoj nga përgjigja.

19 PY. Dhe ajo që po përpiqeni të thoni ju në kontekstin e
20 Kosovës që ishte akoma në kontekstin e 1989?

21 PË. Ata kishin, shtetet e tjera komuniste kishin ndërmarrë
22 procesin e reformave në forma të ndryshme, pra, kishin
23 revolucionin e tyre. Por në Kosovë kjo nuk kishte ndodhur në
24 fakt sepse ishte vendi nën okupim, pastaj lufta, pastaj kishin
25 mbetur që të përpiqeshin të krijonin diçka pa zhvilluar asgjë

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 70

1 që nga viti 19989, kur autonomia e tyre u hoq.

2 PY. Dhe ju thatë që ata, e kam fjalën, popullsia e Kosovës,

3 populli i Kosovës, kishin një mosbesim të thellë ndaj

4 institucioneve zyrtare dhe një prirje të natyrshme për të

5 ndërtuar struktura paralele, për çfarë e keni fjalën?

6 PË. Pas gjithë kësaj, pra, deri në vitin 1989 dhe më vonë,

7 ata ishin vetëadministruar përmes strukturave paralele dhe të

8 gjithë ato që ne duhet t'i konsideronim si shërbimet normale

9 shtetërore siguroheshin përmes strukturave paralele, gjithçka,

10 nga shkollimi deri tek mbledhja e mbeturinave, e plehrave.

11 Pra, ata ishin mësuar me strukturat paralele që kryenin këto

12 shërbimi për të cilat shoqëria kishte nevojë.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, dorëzoj këtë dokument

15 si provë, DHT0568 deri në DHT05686 dhe mund të jetë publik.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë

17 komandant?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT05680 deri

20 në 05686 pranohet.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky do të marrë numrin e

22 provës materiale 1D00409 dhe klasifikohet si publik.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. Sekretar, mund të shfaqni në ekran, ju lutem, DHT05687

25 deri në DHT05730.

1 PY. Siç e sheh, ky është një telegram i dërguar nga z.
2 Kouchner në New York. Dhe është ka të bëjë me një raport
3 periodik, draftraporti periodik për Sekretarin e Përgjithshëm
4 siç thuhet:

5 "Siç kemi diskutuar këtu gjeni raportin periodik i
6 Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un."

7 Siç ju pyeta më herët, UNMIK-u kishte rol në përgatitjen
8 e këtyre dokumenteve. Siç thuhet në Pikën 1, kështu është si
9 përgatiteshin raportet e Sekretari të Përgjithshëm?
10 PË. Po.

11 PY. Në fjalinë e dytë të paragrafit 2 reflektohet shqetësimi
12 i UNMIK-ut se në përmbajtje të raportit në New York mund të
13 hynin interesa të tjera?

14 PË. Siç kam kuptuar, a e kam kuptuar si duhet se ju në terren
15 i përgatisnit dokumentin i cili bënte pjesë të raportin të
16 Sekretarit të përgjithshëm i cili paraqitej Asamblesë së
17 Përgjithshme?

18 PË. Po, ashtu është. Sipas mundësive tona.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë të kalojmë në DHT05688,
20 faqja pasuese, në paragrafin e tretë.

21 PY. Ku thuhet:

22 "Të tre partitë rivale kryesore në Kosovë bashkëpunojnë
23 njëra me tjetrën si pjesë e Këshillit të Përkohshëm
24 Administrativ dhe të Strukturës së Përbashkët Administrative
25 të Përkohshme. Këto parti politike, në fakt, nënshkruesit e

1 Rambujesë janë Lidhja Demokratike e Kosovës, (LDK-ja) e Dr.
2 Ibrahim Rugovës, koalicioni i Lëvizjes së Bashkuar Demokratike
3 (LBD) e Rexhep Qosjes dhe Partia e Progresit Demokratik të
4 Kosovës (PPDK) e z. Hashim Thaçi. Në të njëjtën kohë, të
5 gjitha partitë politike të shqiptarëve të Kosovës po
6 përgatiten për të marrë pjesë në zgjedhjet vendore gjatë këtij
7 viti."

8 Ky përshkrim a përputhet me atë që ju kujtohet juve për
9 atë që ka ndodhur në Kosovë në shkurt të 2000?
10 PË. Po.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në paragrafin 12.
12 PY. Mund të lexoni po aty thuhet në mes të paragrafit, ku
13 thuhet që:

14 "Të gjithë organet paralele të shqiptarëve të Kosovës
15 ..."

16 A e sheh këtë pjesë?

17 PË. Po.

18 PY. "Të gjitha organet paralele të shqiptarëve të Kosovës
19 kanë deklaruar se kanë pushuar së ekzistuari më 31 janar. Të
20 ashtuquajturat 'Ministri të Qeverisë së Përkohshme' të
21 vetëshpallur kanë ndaluar punën më 31 janar. Megjithëkëtë, më
22 31 janar, i ashtuquajturi 'Parlament' e shtyu vendimin në të
23 ardhmen e tij dhe e ashtuquajtura 'Qeveri e Republikës së
24 Kosovës', 'Kryeministri' Bukoshi njoftoi se vetëm do ta
25 pezullonte punën e saj." Kalojmë në faqen tjetër, "më 2

1 shkurt, Dr. Rugova, presidenti i LDK-së dhe presidenti i të
2 ashtuquajturit 'Parlament', deklaroi në mënyrë autoriteteve se
3 të gjitha strukturat e tyre kishin pushuar së ekzistuari më 31
4 janar. Dy ditë më vonë, z. Bukoshi bëri një njoftim të
5 ngjashëm. Megjithëkëtë, për shumë shqiptarë të Kosovës ka qenë
6 e vështirë që ta pranojnë shpërbërjen e strukturave paralele.
7 Një numër personash, për një numër personash që kanë marrë
8 pjesë në këto struktura paralele vendet e punës për ta janë të
9 pakta."

10 Ju kam pyetur më herët lidhur me Dr. Rugovën i cili e
11 paraqiste veten si president. A të kujtohet nëse edhe LDK-ja
12 kishte struktura paralele në Kosovë në kohën kur keni
13 mbërritur ju?

14 PË. Po.

15 PY. Po kështu a keni pasur dijeni që dhe z. Bukoshi të ketë
16 drejtuar qeverinë e tij paralele?

17 PË. Po. Ishte diku më në sfond. Nuk ishte me aq shqetësuese
18 ose të paktën ne nuk na dukej aq shqetësuese ajo sesa
19 strukturat e LDK-së.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi dhe një dokument tjetër edhe
21 një pjesë tjetër në këtë dokument.

22 Në faqen 7, DHT05694.

23 PY. Nuk do ta lexoj me zë të lartë, po ju lutem lexoni
24 paragrafin 27 dhe më tregoni nëse kjo përputhet me mënyrën
25 sesi e keni kuptuar ju procesin e çarmatosjes. Faleminderit.

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 74

1 PË. Këtë lloj informacioni ne zakonisht e kemi marrë nga
2 KFOR-i. Dhe, po, kështu do të më kujtohej.

3 PY. Ky është një informacioni të cilin ju pastaj e merrnit
4 dhe ia dërgonit Sekretarit të Përgjithshëm që ta bënte pjesë
5 të raportit të tij?

6 PË. Po.

7 PË. Nëse më lejohet të shtoj? Dhe ne donim që ky informacioni
8 të ishte i pranishëm në atë raport.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, e paraqes si provë
11 materiale këtë dokument nga faqja DHT05687.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
13 kundërshtim?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT05687 deri
16 në 5730 pranohet.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të ketë numrin
18 1D00401 dhe ka klasifikimin konfidencial.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thatë 01. E
20 keni fjalën 10?

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po e qartë. Po e
22 përsëris, i nderuar Gjykatës, 1D00401. Po ju kërkoj ndjesë, po
23 e bëj dhe një herë 1D00410,

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të mund të jetë publike.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ta

Dëshmitari: James Covey (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 75

1 riklasifikojmë si publik.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, DHT055307
3 deri në DHT055401.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, a mund
5 të jepni dhe një herë numrin rendor.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] DHT055307 deri në DHT055401.

